

ANALIZË E MONITORIMIT TË REALIZUAR MBI RASTET GJYQËSORE NGA FUSHA E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT

RAPORTI I PROJEKTIT MONITORIMI I RASTEVE GJYQËSORE NË FUSHËN E KRIMIT TË
ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT SIPAS LIGJIT TË RI PËR PROCEDURË PENALE PËR 2017

ANALIZË E MONITORIMIT TË REALIZUAR MBI RASTET GJYQËSORE NGA FUSHA E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT

Shkup, nëntor 2017

Projekti financohet nga Departamenti i Shtetit Amerikan - Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Shkup, Byroja për Luftë Ndërkombëtare Kundër Narkotikëve dhe Zbatimin e Ligjeve.



Përmbajtja dhe konkluzat në këtë publikim nuk paraqesin qëndrimet e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shkup, Byrosë për luftën ndërkombëtare kundër narkotikëve dhe zbatimit të ligjeve.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

343.352:343.9.02]:347.953(497.7)(047)

PETREVSKA, Natali

Analizë e monitorimit të realizuar mbi rastet gjyqësore nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit : monitorim i proceseve gjyqësore nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit sipas ligjit të ri për procedurë penale / [autor Natali Petrevska ; përktheu nga gjuha maqedonase Vjosa Taipij]. - Shkup : Koalicioni i shoqatave të qytetarëve "Të gjithë për gjykim të drejtë", 2017. - 59 стр. : граф. прикази ; 25 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 58-59

ISBN 978-608-4552-40-6

а) Корупција - Организиран криминал - Судски одлуки - Мониторинг - Македонија - Извештаи

COBISS.MK-ID 105344010

ANALIZË E MONITORIMIT TË REALIZUAR MBI RASTET GJYQËSORE NGA FUSHA E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT

Botuesi: Koalicioni i shoqatave të qytetarëve
"Të gjithë për gjykim të drejtë"
Rr. Makedonija 11 / 2-10, 1000 Shkup
Tel/Faks: +389 2 6139874
E-mail: contact@all4fairtrials.org.mk
Ueb: www.all4fairtrials.org.mk

Për botuesin: Dr. Mirjana Ivanova Bojadzievska,
Kryetare

Autor: Natali Petrevska
Drejtor Ekzekutiv

Redaktor: Natali Petrovska,
Drejtor Ekzekutiv

Zbatuesi: Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë"

Bashkëpunëtorë: Daniel Mitkovski,
Asistent i Projektit

Adv. Vladimir Andreevski,
Irina Veljanovska,
Darko Avramovski,
Elena Nakovska,
Mbikëqyrës

**Përktheu nga gjuha
maqedonase:** Vjosa Taipi

Dizajni dhe print: Grafhartija

Tirazh: 50

PËRMBAJTJA

FALËNDERIM	1
HYRJE	2
PËR KOALICIONIN "TË GJITHË PËR GJYKIM TË DREJTË"	5
1. GJENEZA DHE FILLIMET E FENOMENIT KORRUPSION DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR	6
2. KORNIZA JURIDIKE	8
3. ANALIZA E POLITIKËS NDËRKOMBËTARE DHE NDIKIMI I DËNIMIT MBI KRYERËSIT	11
4. KORRUPSIONI SI MËNYRË E JETËS	13
5. KRITIKAT DHE UDHËZIMET E Z. RAINHARD PRIBE	13
6. PËR PROJEKTIN, QËLLIME DHE METODOLOGJIA	16
6.1. Për projektin	16
6.2. Qëllime	16
6.3. Metodologjia.....	16
7. ANALIZA E REZULTATEVE NGA MONITORIMI I LËNDËVE NGA FUSHA E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT	17
7.1. Të dhënat themelore	17
7.2. E drejta për mbrojtës	20
7.3. Procedurë e shkurtuar	21
7.4. Pranimi i fajit	26
7.5. Procedura provuese.....	28
7.6. Transparenca gjatë procedurave	34
7.7. Parimi i paanshmërisë	36
7.8. Prezumimi i pafajësisë.....	38
7.9. E drejta e mbrojtjes	38
7.10. Shqiptimi dhe publikimi i aktgjyqimit	41
7.11. Politika dënuese në aktgjykimet e shpallura publike	41
8. LËNDË GJYQËSORE TË PROFILIT TË LARTË	43
8.1. “Komuna Qendër”	43
8.2. “Kalaja 2”	46
8.3. “Lagjja e trimave”	48
8.4. “Rover”	48
8.5. “Bozhinovski”	49
8.6. “Dhuna në Kuvend”	50
8.7. “Pavle Bogoevski”	50
8.8. “E majta”	51
8.9. “Mariglen”	52

8.10. “Lagjja e trimave” – procedurë e veçuar	52
8.11. “Ryshfeti”	53
8.12. “Sopoti”	53
9. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	54
9.1. Konkluzione të përgjithshme.....	54
9.2. Konkluzione dhe rekomandime nga monitorimi i zbatuar	56
10.LITERATURË E PËRDORUR:	58

FALËNDERIM

Të nderuar,

Koalicioni "Të gjithë për gjykime të drejta" ju paraqet edhe një analizë tjetër të projektit "Monitorimi i çështjeve gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsion sipas Ligjit të ri për procedurë penale", i cili fokusohet në çështjet që e trajtojnë çështjen e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe zbatimin e Ligjit të ri për Procedurën Penale.

Në analizë janë përmbledhur të dhënat nga monitorimi i rasteve gjatë vitit 2017 në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në Seksionin për Krim të Organizuar dhe Korrupsion, lëndë me rëndësi publike dhe mostër e përzgjedhur e lëndëve për korrupsion, dhe bazuar në këto të dhëna, po i shqyrtojmë çështjet e pavarësisë, efikasitetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit maqedonas në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe vlerësimin e implementimit adekuat të reformave juridike penale me fokus të kryesor në LPP të ri.

Personi përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve të projektit, analizimin e të dhënave të fituara dhe në pjesën më të madhe përpilimin e analizave është Drejtoresha Ekzekutive - Natali Petrovska, e cila meriton pa rezerva vlerësimet pozitive. I gjithë procesi u ndihmua në mënyrë bujare nga angazhimi profesional i ndihmësit të projektit Daniel Mitkovski, veçanërisht në përpilimin e data bazës - si dhe mbikëqyrësit e përfshirë drejtpërdrejt në monitorimin e lëndëve dhe pa kontributin e të cilëve kjo analizë do të ishte e paplotë.

Dua të shpreh mirënjohjen time të veçantë për Departamentin Shtetëror Amerikan - Ambasadën e Shteteve të Bashkuara - Byroja për luftë ndërkombëtare kundër narkotikëve dhe zbatimin e Ligjeve, sugjerimet e të cilëve gjatë realizimit të aktiviteteve të projektit dhanë një kontribut cilësor në produktin përfundimtar të projektit, si dhe për mbështetjen financiare dhe bashkëpunimin e suksesshëm nga viti 2014 deri më sot.

Dr. Mirjana Ivanova Bojaxhievska
Presidente e
Koalicionit "Të gjithë për gjykim të drejtë"

HYRJE

Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejta" paraqet një organizatë në të cilën janë anëtare 15 organizata të shoqërisë civile nga i tërë territori i Republikës së Maqedonisë. Misioni themelor në ekzistimin e deritanishëm është monitorimi i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, veçanërisht standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë përmes formave të ndryshme të veprimit. Me zhvillimin e programit për monitorim të lëndëve gjyqësore në lidhje me korrupsionin, Koalicioni filloi në vitin 2007 përmes një faze pilot gjashtëmujore të quajtur "Vlerësimi i Nevojave për zhvillimin e programit për monitorimin e korrupsionit në Republikën e Maqedonisë". Me këtë pilot projekt të parë u mbledhën materiale empirike në bazë të së cilave dolën në sipërfaqe më shumë probleme me të cilat përballen organet e ndjekjes gjatë punës së tyre me lëndët të lidhura me korrupsionin. Në kuadër të këtij pilot projekti u bë përkufizimi i veprave kriminale të lidhura me korrupsionin nga aspekti i legjislacionit dhe praktikës gjyqësore. Përkufizimi përfundimtar identifikoi 24 krime që janë në përputhje të drejtpërdrejtë me korrupsionin.

Në periudhën nga viti 2012 deri në vitin 2013, vijon projekti: Monitorimi i rasteve në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit, i zbatuar ekskluzivisht në territorin e Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup, ndryshe nga vitet e kaluara ku monitorimi kryhej në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë. Gjatë zbatimit të këtij projekti u përfshinë 20 monitorues të trajnuar, të cilët monitoronin lëndët në Gjykatën Themelore Shkup 1, Shkup në periudhën prej 1 shtator 2012 deri më 31 gusht 2013, dhe atë vetëm ato që mbahen në seksionin për Krim të organizuar dhe korrupsion. Kjo është për shkak të shkeljeve të ndjeshme të të drejtave të njeriut të të akuzuarve nga njëra anë, si dhe faktit se serioziteti dhe lufta ligjore kundër korrupsionit nga ana tjetër është nevojë thelbësore për krijimin e një shoqërie demokratike. Me vetë faktin se vetëm Gjyqi themelor Shkup 1 Shkup ishte kompetent për menaxhimin e këtyre sendeve, monitorimi i tyre mbulonte tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

Viti 2015 ishte viti edhe i një analize tjetër të projektit "Monitorimi i lëndëve gjyqësore nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit sipas Kodit të ri të Procedurës Penale", e cila fokusohet në çështjet që trajtojnë problematikën e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe zbatimin e LPP të re. U monitoruan lëndë në periudhën prej shkurt 2015 deri në tetor 2015 dhe projekti u mbështet financiarisht nga Departamenti i Shtetit Amerikan - Zyra Shtetërore për Narkotikët ndërkombëtar dhe Seksioni i punëve të brendshme. Përmes monitorimit të procedurave gjyqësore nga monitoruesit me përvojë të gjykatave, u fituan të dhëna statistikore mbi mënyrën e zbatimit të Ligjit të ri për procedurën penale në procedura të ndryshme penale të cilat do të përbëjnë bazën për përgatitjen për shqyrtimin e plotë të numrit të autorëve të zbuluar dhe të sqaruar të këtij lloji të krimit dhe rritja e tyre në raport me vitet e mëparshme. Rezultatet tregojnë (sipas numrit të lëndëve) për luftë jo efektive kundër korrupsionit. Nga i gjithë publiku i ekspertëve vijojnë kritika për ngecjen e vendit në aspektin e sundimit të ligjit.

E lartpërmendura tregon nevojën e madhe për zhvillimin e një programi për monitorimin e procedurave gjyqësore në lidhje me korrupsionin në Republikën e Maqedonisë.

Viti i kaluar 2016 ishte viti edhe i një analize tjetër të projektit "Monitorimi i lëndëve gjyqësore nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit sipas Kodit të ri të Procedurës Penale", e cila fokusohet në çështjet që trajtojnë problematikën gjatë në zgjedhjes së lëndëve nga sfera e krimit të organizuar dhe korrupsionit, por edhe për të gjitha reformat e mbështetura dhe aktualitetet e lidhura me gjyqësorin në përgjithësi.

Analizat nga vëzhgimet kanë treguar gjatë disa viteve të fundit në fushën e korrupsionit, janë veçuar veprimet kriminale "Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimeve zyrtare" dhe "Mashtrimi", si vepra që përsëriten më së shpeshti me secilën anketë vjetore. Veprat e tjera penale në fushën e korrupsionit ose rrallë kryhen në realitet ose mënyra e realizimit të tyre krijon vështirësi në sigurimin e provave të nevojshme për përcaktimin e plotë të gjendjes faktike. Megjithatë, nuk duhet të lihet anash fakti se gjatë raportimit ka selektivitetin ndaj kryerësve dhe përpunimin e procedurave, sidomos me kontroll të parregullt të gjendjes së pronës së zyrtarëve, që është puna e KSHPK-së.

Për realizimin e suksesshëm të këtij projekti, e një rëndësie të veçantë është qasja metodologjike e cila përcakton cilësinë e rezultateve të fituara, suksesi në depërtimin e fenomenit që hetohet me të gjitha karakteristikat e tij. Efikasiteti në luftën kundër korrupsionit shkencërisht kërkon përdorimin e të gjitha mjeteve dhe metodave në dispozicion, si ato klasike-konvencionale ashtu ato dhe moderne.

Duke u nisur nga pasojat e dëmshme të korrupsionit, hulumtimi duhet të depërtojë sa më thellë në lëndët gjyqësore dhe gjatë çka duke monitoruar procedurën nga fillimi deri në fund, do të jetë e mundur të sigurohet një pasqyrë e qartë e të gjitha segmenteve të ngjarjes konkrete penale dhe ligjore nëpërmjet pjesëmarrësve, kryerësve të veprës penale të korrupsionit, nëse niveli i tyre i arsimit është recidiv ose është shkelës i parë, vendi i punës së tij - një funksion që mundëson ekzekutimin e një veprë të tillë, nëse bëhet fjalë për shërbim apo kundër shërbim edhe pse në të dyja baza është shpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autoritetit. Pastaj është e nevojshme të monitorohet vetë procesi në të gjitha fazat, duke monitoruar aktivitetin e të gjitha subjekteve në procedurë. Monitorim nga aktakuza e ngritur deri në momentin e miratimit të Aktvendimit të plotfuqishëm gjyqësor

Te ky lloj i veprave penale, për shkak të specifikës së të njëjtave, në veçanti duhet të analizohet praktika gjyqësore lidhur me shqiptim të masës së posaçme penale, gjegjësisht konfiskimin e pasurisë dhe pronës. Konfiskimi i mallrave të fituara në mënyrë kriminale, i të ardhurave nga krimi që rrjedhin nga veprat penale përkatëse ose pronësisë vlera e së cilës është adekuate me atë të të ardhurave ose konfiskimin e pasurisë, pajisjeve dhe mjeteve të tjera të përdorura ose të dedikuara për kryerjen e veprës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të përcaktuar pikërisht për shkak të natyrës së këtij lloji të veprave penale.

Sanksionet e shqiptuara janë gjithashtu një segment shumë i rëndësishëm në këtë hulumtim, veçanërisht në drejtim të arritjes së qëllimit të dënimit, dmth. krahasuar me

dy vjet më parë, nëse politika ndëshkuese shkon në drejtim të sipërm dhe shqiptohen dënime më të rrepta (burgim, gjoba, masa alternative) ose janë shqiptuar gjoba më të buta.

Shqyrtimi i vetëm i secilës prej qëllimeve të caktuara do të mundësojë krijimin e një tabloje realiste të situatës aktuale, e cila, nga ana tjetër, do të krijojë kushte për gjetjen e zgjidhjeve më adekuate për përmirësimin e efikasitetit gjyqësor nëpërmjet respektimit të plotë të të drejtave dhe lirive të garantuara.

Duke respektuar dhe marrë para sysh tablonë reale të situatës me këtë lloj krimi, si dhe me aftësinë e gjyqësorit për t'u marrë me këta kryerës, krahasuar me shumë vite më parë, do të shihen rezultatet dhe progresi i pritshëm në punën e gjykatave në lëndët me elemente të korrupsionit dhe do të marrë një përgjigje në pyetjen nëse ka përmirësim dhe sukses në trajtimin e luftës kundër ndikimit të korrupsionit në punën e institucioneve.

Ky është motivi i Koalicionit "Të gjithë për gjykim të drejtë" dhe pas 10 vjetësh të vazhdojë monitorimin e lëndëve gjyqësore për të përcaktuar situatën e re, për të nxjerrë përfundime dhe rezultate në bazë të vëzhgimit dhe për të përcaktuar rekomandimet dhe sugjerimet për forcimin e efikasitetit të gjyqësorit në luftën kundër këtij fenomeni të dëmshëm shoqëror.

Dr. Mirjana Ivanova Bojaxhievska
Presidente e
Koalicionit "Të gjithë për gjykim të drejtë"

PËR KOALICIONIN "TË GJITHË PËR GJYKIM TË DREJTË"

Koalicioni i shoqatave qytetare "Të gjithë për gjykim të drejt" - Shkup parqet një organizatë në të cilën janë anëtarë 15 organizata qytetare i tërë territori i RM-së dhe atë: Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë Megjashi - Shkup, Shoqata e Qytetarëve MOST - Shkup, Forumi Arsimor Rinor MOF Shkup, Qendra Kulturore Rinore MKC - Manastir, Asociacioni për Iniciativë Demokratike ADI - Gostivar, Këshilli për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve (KPDM) SPPMM - Kavadar, Shoqata për Këshillim, shërim, riintegrim dhe ri-socializmi IZBOR - Strumicë, Shoqata për të Drejtat e Romëve (ShDR) ZPR - Shtip, Shoqata për të Drejtat e Fëmijëve ZPD - Shkup, Qendra për Informim Qytetar GIC SPEKTAR - Shtip, Shoqata humanitare e romëve HDZR MESÇINA - Gostivar, Shoqata e romëve të Tikveshit ZRT - Kavadar, Qendra Edukative rome (QER) REC AMBRELA - Shkup, Shoqata e Qytetarëve MULTIKULTURA - Tetovë dhe Shoqata për Qasje Kritike ndaj Gjinisë dhe Seksualitetit SUBVERSIVEN FRONT, Shkup.

Misioni

Monitorimi i respektimit të drejtave dhe lirive të njeriut, sidomos standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë, përmes formave të ndryshme të veprimit në përpjekje për të rritur nivelin e zbatimit të tyre, të iniciohen reforma institucionale dhe ligjore dhe rivendosjen e besimit të qytetarëve në gjyqësor dhe institucione të tjera të sistemit.

Vizioni

Organizim i fuqishëm dhe i qëndrueshëm, promotor dhe partner i institucioneve të sistemit, në përpjekje për të ngritur Republikën e Maqedonisë si një vend ku të drejtat dhe liritë e njeriut do të respektohen plotësisht, me theks të veçantë në standardet e gjyqimit të drejtë si kusht elementar për integrimin në Bashkimin Evropian.

Qëllimet e Koalicionit

- Të rritet respektimi i standardeve të gjyqimit të drejtë në gjykatat vendore;
- Të themelohet besim publik në sistemin ligjor dhe gjyqësorin në përgjithësi;
- Të identifikohen problemet e trashëguara në sistemin gjyqësor dhe të sugjerojë për nevojën për reforma ligjore dhe institucionale;
- Ta njoftojë publikun me standardet për gjykim të drejtë dhe ta forcojë besimin e qytetarëve në funksionimin e sistemit gjyqësor;
- Të zvogëlohen mundësitë për trajtim joadekuat të palëve në kontestin nga gjyqtarët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë.

1. GJENEZA DHE FILLIMET E FENOMENIT KORRUPSION DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Republika e Maqedonisë këtë vit kremtoi 26 vite pavarësi dhe ekzistencën e një shteti ligjor. 26 vjet të pasuar nga një seri dridhje të mëdha shoqërore-shkatërruese, por gjithashtu edhe me përgjigje ligjore dhe zgjidhje jashtëzakonisht joadekuate për situata të tilla. Fenomeni i "sëmundjeve" që përfshinë shoqëritë moderne nuk u la prapa në as te ne dhe kështu një nga më të vështirat - korrupsioni është pjesë integrale e dëmtimit tonë nga pavarësia e saj.

Në mënyrë që të mund t'i qasemi fenomenologjisë së këtij fenomeni, është e nevojshme në radhë të parë të përkufizohet në mënyrë që do ta bënte më të lehtë për të kuptuar natyrën e tij. Termi vjen nga fjala latine "corruptus" që fjalë për fjalë do të thotë "jashtëzakonisht i prishur". Rregullorja në Republikën e Maqedonisë e definon korrupsionin si: "Përdorimi i funksionit, autoritetit publik, detyrës zyrtare dhe pozitës për të arritur ndonjë lloj dobie për veten ose për të tjerët"¹. Me dobi nënkuptohet realizimi i çdo lloji të dobisë, komoditet ose përparësi për vete ose për tjetër. Edhe pse një fenomen i tillë ndodh në të gjitha shtetet moderne, korrupsioni është veçanërisht karakteristik për vendet në tranzicion, të cilat zhvillohet demokracia, të drejtat e njeriut dhe ekonomia e tregut. Një problem shtesë për këto vende është legjislacioni i pamjaftueshëm, institucionet "e dobëta" dhe përdorimi i boshllëqeve ligjore që, pas pavarësisë, ishin në dispozicion të individëve të caktuar dhe boshllëqet i mbushnin me qëllimet dhe interesat e tyre fitimprurëse, duke pasur parasysh se shteti ende nuk ka mekanizma të mjaftueshëm të zhvilluar për t'i shtypur ose parandaluar situatat e tilla. Korrupsioni nuk ka vetëm një fytyrë, kështu që mund të duket si korrupsion politik, i njohur zakonisht si kleptokraci, "sundimi i hajdutëve", ose në formën e ryshfetit, zhvatjes, nepotizmit, patronazhit, mito etj. Përkundër faktit se nuk ka asnjë vend në botë që është imune ndaj korrupsionit dhe formave të saj, është e nevojshme të shtrohet pyetja: A është bërë dhe si është bërë Republika e Maqedonisë një terren pjellor për zhvillimin e korrupsionit, por edhe të krimit të organizuar si një nga konceptet më kontradiktore me të cilat ka funksionuar në vitet e fundit?

Krimi i organizuar është një fenomen në shkencat shoqërore dhe në atë moderne, e cila në mënyrë të pashmangshme lidhet me ekzistencën e korrupsionit. Një sqarim i tillë mund të kuptohet si mjaft i thjeshtë, duke pasur parasysh shkallën në të cilën krimi i organizuar kërcënon të shkatërrojë rendin juridik të shteteve moderne. Për këtë qëllim, është e nevojshme të përmendim përkufizimin më të gjerë që i jepet këtij nocioni nga Akademik Vlado Kambovski: "Kryerja e veprimeve kriminale nga shoqatat kriminale me qëllim të realizimit të fitimit dhe / ose arritjes së pushtetit, përdorimit të dhunës, ose duke përdorur pozicionin e veçantë në shoqëri duke zvogëluar rrezikun përmes angazhimit në

¹ Neni 1-a i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit - teksti i pastruar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 28/02, 04 / 04, 126 / 06, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të datës 10.01.2007, 10/08, 161/08)

aktivitete ligjore ekonomike, politike dhe të tjera, si dhe hartimin e një sistemi paraprak për mbrojtje kundër ndjekjes penale "²

Një përkufizim i rëndësishëm gjithashtu është dhënë në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (Palermo, 2000) për një grup kriminal të organizuar. Sipas kësaj konvente, një grup kriminal i organizuar është "i përbërë nga tre ose më shumë persona që ekzistojnë për një periudhë të caktuar dhe veprojnë në mënyrë që të kryejnë një ose më shumë vepra të rënda të themeluara nga kjo Konventë me qëllim të përfitimit financiar të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ose përfitim tjetër material "³.

Para se të lejohet përpunimi i hollësishëm i zhvillimit, zbatimi i mekanizmit dhe sanksioneve me të cilat shteti përpiket të parandalojë një veprim të tillë, është e nevojshme të pranohet lidhshmëria e këtyre dy fenomeneve.

Domethënë, krimi i organizuar mbështetjen e tij e tërheq nga korrupsioni. Korrupsioni paraqet condition sine qua non për zhvillimin e krimit të organizuar dhe bazën për këtë e gjejmë në natyrën e lehtë të korrupsionit të njeriut në periudhën pas shpërbërjes së ish-federatës (RSFJ) dhe formimit të Republikës së Maqedonisë si shtet i pavarur. Krimi i organizuar si një rrjet me një numër të madh pjesëmarrësish si individë, si dhe kompani (të mëdha), ndërmarrje, por edhe autoritetet shtetërore është i mundur vetëm nëse në sistem kemi persona të gatshëm të jenë bashkëpunëtorë dhe mund të shohin paqësisht rrënimin e sistemit nga brenda me vetë faktin se ata vetë e ndihmuan atë. Korrupsioni konsiderohet të jetë jo vetëm një nga format e krimit të organizuar, por edhe faza më e lartë zhvillimore në të cilën korrupsioni shndërrohet në një "shtet në shtet" dhe ndodh një kriminalizim absolut i sistemit politik dhe ekonomik dhe shteti kthehet në një organizatë klasike kriminale.

² Kambovski V, "Shteti ligjor dhe krimi i organizuar", Fakulteti Juridik Shkup, 1996

³ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional, Palermo 2000

2. KORNIZA JURIDIKE

Pas pavarësisë, Republika e Maqedonisë u bë anëtare e Kombeve të Bashkuara më 8 prill 1993, anëtare e OSBE-së më 12 tetor 1995, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit me BE u mbyll me 9 prill 2001 dhe hyri në fuqi më 1 prill 2004 për në vitin 2005, Republika e Maqedonisë të marrë statusin e një vendi kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Të gjitha këto vite, duke filluar nga pavarësia në vitin 1991, autoritetet në Republikën e Maqedonisë kanë luftuar korrupsionin që ishte masivisht i pranishëm në të gjitha sferat dhe krimin e organizuar dhe si rezultat kemi nënshkruar dhe ratifikuar konventat më të rëndësishme ndërkombëtare dhe evropiane.

Republika e Maqedonisë është anëtare e Grupit të shteteve kundër korrupsionit (GREKO) që nga viti 2000. Më 27 janar 1999 në Strasburg u hap për nënshkrimin e Konventa ndëshkimore për korrupsionin, e cila u nënshkrua dhe u ratifikua nga Republika e Maqedonisë më 28 korrik 1999 dhe hyri në fuqi më 1 korrik 2002. Në vitin 1999 u nënshkrua Konventa evropiane për ndihmën e përbashkët për çështjet kriminale. Në vitin 2000, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin Trans nacional u nënshkrua dhe u ratifikua në vitin 2005. Gjithashtu janë ratifikuar të dyja, Konventa e Këshillit të Evropës mbi të Drejtën Penale Kundër Korrupsionit (1999), Konventa për të Drejtën Civile Kundër Korrupsionit (2002) dhe Protokollin Shtesë të Konventës mbi të Drejtën Penale Kundër Korrupsionit (2005). Në vitin 2007. Maqedonia e ratifikoi Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit.

Kur bëhet fjalë për tekst ligjor të veçantë në kuadrin ligjor vendor, është veçanërisht e rëndësishme të përmendet ligji i parë për parandalimin e korrupsionit i vitit 2002, i cili përmban një numër dispozitash për forcimin e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit si në administratën publike ashtu edhe në funksionarët e zgjedhur / të emëruar. Në nëntor të vitit 2002 gjithashtu u krijua Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, i cili sot ka rolin e një trupi të pavarur përgjegjës për zbatimin e masave anti-korrupsion dhe konflikteve të interesit.

Në vitin 2004, me miratimin e Ligjit të ri për Prokurorinë Publike Themelore u krijua Seksioni për vepra penale në fushën e krimin të organizuar dhe korrupsionit, i cili në vitin 2007 u bë zyra e posaçme e prokurorisë për trajtimin e rasteve të lidhura me krimin e organizuar dhe korrupsionin në nivelin e të gjithë territorit të Republikës së Maqedonisë.

Neni 31 i Ligjit mbi Prokurorinë Themelore Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 150, data 12.12.2007) i përcakton kufijtë e veprimit të prokurorisë publike, por, ndër të tjera, jep një pasqyrë të qartë se çfarë do të trajtohet si korrupsion dhe cilat vepra të kodit penal janë të përfshira.

Neni 31: "Prokuroria Themelore publike e prokurorisë për ndjekjen e krimin të organizuar dhe korrupsionit është kompetente të veprojë:

- për vepra penale të kryera nga një grup i strukturuar i tre ose më shumë personave që kanë një periudhë të caktuar kohore dhe vepronë në mënyrë që të kryejnë një ose më shumë vepra penale për të cilat parashikohet një dënim me burg prej të paktën katër vjet me qëllim në mënyrë direkt ose indirekt, të fitohet dobi financiare ose dobi tjetër,...
- për veprat penale të kryera nga një grup i strukturuar ose organizatë kriminale në territorin e Republikës së Maqedonisë, në shtete të tjera ose kur vepra penale është përgatitur ose planifikuar në Republikën e Maqedonisë ose në një vend tjetër,
- për veprat penale shpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit nga neni 353 paragrafi (5), marrja e ryshfetit me vlerë të konsiderueshme të përmendur në nenin 357 dhe ndërmjetësimi i paligjshëm i referuar në nenin 359 i të gjithë nga Kodi Penal, të kryera nga një funksionar i përzgjedhur apo i emëruar, person zyrtar ose person përgjegjës i zgjedhur juridik dhe
- për vepra penale, prodhim të paautorizuar dhe lëshimin në shitje të narkotikëve, substancave psikotrope dhe prekursorëve nga neni 215 paragrafi (2), shpëlarjen e të parave dhe të ardhurave të tjera të një veprë penale me vlerë më të madhe se neni 273, kërcënimi terrorist ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë nga neni 313, ryshfet me vlerë të konsiderueshme nga neni 358, ndikimi i paligjshëm ndaj dëshmitarëve nga neni 368-a paragrafi (3), shoqata kriminale nga neni 394, organizata terroriste nga neni 394-a, terrorizmi nga neni 394-b, veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore nga neni 418-a, veprat penale të kontrabandimit me emigrantët nga neni 418-b, trafikimi i të miturve nga neni 418-g dhe krime të tjera kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare të Kodit Penal, pavarësisht nga numri i autorëve ".

Ky nen pasqyron qartë format e ndryshme në të cilat mund të paraqitet korrupsioni, që nënkupton se ajo është e pranishme drejtpërdrejt ose indirekt në pjesën më të madhe të jetës së njerëzve. Numri i konventave të nënshkruara dhe të ratifikuara si dhe ndryshimet e shumta ligjore flasin për ekzistencën e një vullneti të singertë dhe një angazhimi nga shteti për shtypjen e korrupsionit dhe trajtimin e krimit të organizuar. Por, të njëjtat nuk përbëjnë në vetvete një garanci se ajo që shkruhet dhe parashikohet në to do të jetë dhe do të zbatohet në tërësi.

Prania agresive e korrupsionit kërkon një strukturë të fortë institucionale, që është, institucione dhe organe shtetërore të kualifikuar dhe të ndërlidhur që do të mund t'i mbrojnë në mënyrë efektive qytetarët, por gjithashtu t'i zbulojnë rastet e korrupsionit dhe / ose krimit të organizuar. Për këtë qëllim, vijon një shqyrtim i shkurtër i institucioneve kompetente në Republikën e Maqedonisë, e cila pritet të jetë aktore aktive në këtë luftë.

Padyshim, një nga institucionet kyçe në lidhje me këtë çështje është Ministria e Punëve të Brendshme për parandalimin dhe trajtimin e veprave penale dhe abuzimeve, zbulimin dhe kapjen e autorëve dhe marrjen e masave të tjera për ndjekjen penale të kryerësve të veprave penale.

Trupat që ekzistojnë brenda Ministrisë përfshijnë Byronë e Sigurisë Publike, Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim, si dhe ekzistenca e një Kontrolli të brendshëm për standardet profesionale, e cila është një njësi e veçantë organizative e Ministrisë që kryen vlerësim të ligjshmërisë së veprimtarisë së punonjësve në Ministri. Ky kontroll i brendshëm miraton program anti-korrupsion që synon reduktimin e korrupsionit dhe futjen e një kulture antikorrupsion në mesin e punonjësve të ministrisë, e cila do të jetë në të njëjtin nivel me atë të policisë evropiane dhe do ta forcojë integritetin e punonjësve në ministri.

Seksioni i Krimit të Organizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme është përgjegjës për parandalimin dhe ndjekjen penale të kryerësve të krimit të organizuar dhe bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me Seksionin për ndjekjen e kryerësve të veprave penale dhe korrupsion në kuadër të Prokurorisë publike.⁴

Seksioni për çështjet kufitare dhe emigrimin është formë e veçantë organizative brenda Byrosë së sigurisë publike - Ministria e Brendshme, e cila përveç përgjegjësive të tjera për menaxhimin e sigurisë kufitare, lufton krimin ndër-kufitar, bashkëpunimin ndër-kombëtar dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me entitetet e tjera në Sistemin për menaxhim të Integruar të kufijve⁵.

Seksioni i Krimit të Organizuar në Gjykatën Themelore Shkup 1 është seksion i veçantë për rastet që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit miraton Programin Shtetëror për parandalimin dhe shtypjen e korrupsionit dhe planeve të veprimit për zbatimin e tij, e miraton programin vjetor, planifikon punën dhe përgatit mendime mbi projektligjet e rëndësishme për parandalimin e korrupsionit.⁶

Policia Financiare është themeluar më 26 qershor dhe është organ brenda Ministrisë së Financave (Gazeta Zyrtare 55/02, 26 qershor 2003). Për herë të parë, sipas Ligjit për Policinë Financiare (Gazeta Zyrtare 55/02) vepron si një trup i administratës shtetërore përgjegjëse për ndjekjen penale, gjatë çka siguron kompetenca të veçanta dhe specifike, të tilla si zbulimi i autorëve të përfshirë në veprimtari të paligjshme në fushën e krimit financiar, pastrimit të parave dhe llojeve të tjera të krimit, d.m.th, kontrabandës, shmangies së taksave ose evazionit domethënës të detyrimeve të mëdha doganore dhe detyrimeve të tjera tatimore.⁷

Në vitin 2007, u miratua Ligji i ri për Policinë Financiare (Fig. Gazeta Nr. 55/07) dhe në përputhje me të njëjtën, Policia financiare bëhet Autoriteti i Policisë Financiare, një organ brenda Ministrisë së Financave me kapacitet të një personi juridik.⁸ Drejtoria e

⁴ Neni 3 i Ligjit për Punë të Brendshme i Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 42/2014)

⁵ IBID

⁶ Nuredinoska E. Sazdeski M. Gjuzellov, B. Raporti për vlerësimin e korrupsionit.

⁷ Marrë nga: http://www.finpol.gov.mk/za_upravata.html

⁸ Drejtoria e Policisë Financiare. Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë. Mund të gjendet në: http://www.finpol.gov.mk/za_upravata.html

policisë financiare ka kompetenca në procedurën para hetimore dhe në hetimin, në rastet kur merret me zbulimin e veprave penale dhe autorët e tyre si dhe mbledhjen e provave për ndjekjen penale të kryerësve të veprave penale: evazioni fiskal (neni 279 i KP); pastrimi i parave dhe të ardhurat e tjera nga vepra penale (neni 273 i KP); kontrabandë (neni 278 i KP); tregti e palejuar (neni 277 i Kodit Penal) dhe vepra të tjera penale që përfshijnë shuma më të mëdha dhe të konsiderueshme të tatimeve, doganave apo të ardhurave të tjera.⁹

3. ANALIZA E POLITIKËS NDËRKOMBËTARE DHE NDIKIMI I DËNIMIT MBI KRYERËSIT

Nëse rendi ligjor në një shtet klasifikon sjelljen e caktuar njerëzore si të dënueshme dhe parashikon sanksion për këtë, qëllimi themelor i një sanksioni të tillë është t'i pengojë kryerësit e mundshëm nga kryerja e krimit dhe kryerësit nga përsëritja e një akti të tillë. Disa lloje të veprave penale kundër të cilave nuk janë të përjashtuara as llojet e korrupsionit të rregulluara me kodin penal, janë aq të vështira saqë ato rezultojnë në minimin e rendit shtetëror, me çka ekziston një konsensus ndërkombëtar se autorët e tyre nuk duhet të mbeten të pandëshkuar. Në këtë drejtim, është bërë një shqyrtim i zgjatur i lartësisë së gjobave për lloje të caktuara të lëndëve (lloje të ndryshme të korrupsionit në përputhje me klasifikimin në Kodin Penal) dhe sa ka arritur kjo qëllimin e saj.

Në periudhën prej vitit 2007 deri në 2014, përkatësisht nga themelimi i seksionit të specializuar për krim të organizuar dhe korrupsion në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup, janë miratuar 364 vendime efektive për 1.125 të akuzuar¹⁰ për të cilët zbatohet Kodit Penal i vlefshëm aso kohe dhe Ligji për procedurës penale para hyrjes në fuqi të Kodit të ri për procedurës penale e vitit 2010, i cili lejon zgjidhjen e sanksionit penal. Sipas të dhënave dhe statistikave të Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup, vepra penale më e shpeshtë e kryer në periudhën e dhënë është trafikimi i qenieve njerëzore - 39.53% e të pandehurve janë dënuar për trafikim me qenie njerëzore, ndërsa më të shpeshtët janë kryerësit e veprës penale sipas nenit 418-b të Kodit Penal, trafikimin e emigrantëve.

Dy krimet më të zakonshme për të cilat të pandehurit janë dënuar dhe nuk kanë lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore janë për shoqërim kriminal (neni 394 i Kodit Penal) me 17.72% të të pandehurve në mostër dhe prodhim dhe tregti të paautorizuar të narkotikëve (neni 215 i KP) me 16.47% të të pandehurve nga të dhënat e përpunuara. Aktgjykimet dënuese për vepra në lidhje me korrupsionin publikun nuk janë aq të zakonshme. Për shembull, 8.46% e të pandehurve nga të dhënat e përpunuara janë dënuar për abuzim me pozitën zyrtare dhe autoritetin (neni 353 i KP), 3.83% për pastrimin e parave (neni 273 i KP) dhe 3.03% për pranimin e rryshfetit (neni 357 i Kodit Penal). Rreth

⁹ IBID

¹⁰ Tajd Brasher Lidia, Analiza e politikës për ndëshkimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit, f.4

2% e të pandehurve në ekzemplar janë dënuar për evazion fiskal (neni 279 i Kodit Penal). Rreth 9% e të pandehurve në ekzemplar janë dënuar për vepra penale të tjera, për të cilat jo më shumë se 2% e të pandehurve janë dënuar për të njëjtin krim.¹¹

Në periudhën 2007-2014, 53.5% e të pandehurve ishin dënuar për krim për të cilin kërkohej minimum prej një viti burg ose më pak (21.86% e të pandehurve u ballafaquan me më pak se një vit dhe 31.64% e të pandehurve u përballën me dënim prej një vit burg). Me fjalë të tjera, më shumë se gjysma e të pandehurve u përballën relativisht me minimume të ulëta të detyrueshme prej një viti ose më pak. Minimumi tjetër më i zakonshëm me të cilin përballen të pandehurit është pesë vjet burg, që mbulon 15% të pandehurve. Rreth 13% e të pandehurve hasën dënim të mundshëm minimal prej katër vjetësh, ndërsa rreth 10% u përballën me dënime potenciale prej tetë vjet burg. Shumë numër i vogël nga të pandehurit (rreth 1.51%) janë përballur me dënimin më të lartë prej dhjetë vjetësh.

Të dhëna e tilla tregojnë për përfundimin se në më shumë se gjysmën e rasteve të proceduara, të pandehurit u përballën me burgim prej një viti ose më pak. Përcaktimi i dënimeve të tilla të ulëta dhe të lehta për krimet që në afat të gjatë kërcënojnë të shkatërrojnë të gjithë rendin ligjor nuk është një aksident i thjeshtë, por një padrejtësi. Këmbëngulja e një padrejtësie të tillë padyshim do të shkaktojë shkatërrimin e themeleve të çdo shoqërie, jo vetëm atë në të cilën jetojmë. Këto statistika tregojnë se ky lloj ndëshkimi nuk i pengon kryerësit që të kryejnë veprën, e cila në anën tjetër ngre çështjen e efikasitetit të angazhimit të shtetit, burimeve, institucioneve si dhe forcimit të legjislacionit vendas dhe ndërkombëtar. Nëse ndërhyrjet në të gjitha këto fusha janë bërë për të frenuar ose zvogëluar korrupsionin dhe krimin e organizuar, por edhe për tu ndëshkuar pjesëmarrësit dhe kryesit, dhe kjo rezulton në rastet gjyqësore të procesuara në të cilat jepet një dënim minimal, atëherë në mënyrë legjitime shtrohet pyetja nëse problemi është te dënimi ose vlerësimi i gjykatave nga rasti në rast, se si duhet të jetë e njëjta.

Paralelisht me problemin e mungesës së jo aq "dënimi të rreptë" që do ta pengonte kryerësin, është gjithashtu e nevojshme të shqyrtohet edhe ana tjetër e enigmës. Veprimet karakteristike për korrupsionit dhe krimin e organizuar ka kohë që nuk janë vetëm veprime të paligjshme. Përkundrazi, shtetet dëshmojnë për një numër në rritje të veprimeve juridike të kryera në drejtim të implementimit të korrupsionit. Ky lloj ligjor është më i pranishëm në mesin e funksionareve (gjyqtarë, politikanë, prokurorë, etj.) ose nëpunës të lartë shtetëror, aty ku ata mund të vendosin ose ku mund të ndikojnë. Kur këto procese derdhen nga paligjshmëria, në sferën ligjore, atëherë çdo punë ligjore mund të shihet përmes optikës së korrupsionit potencial.

Ndrydhja e moralit në natyrën njerëzore të shkaktuar nga një sërë faktorësh shoqërorë, si dhe tendenca për korrupsion që të jetë gjithnjë e më e pranishme në sferën

¹¹ Tajd Brasher Lidia, Analiza e politikës për ndëshkimin e krimin të organizuar dhe të korrupsionit, f.9

e të ligjshmes, se të paligjshmes, ka krijuar një fenomen në praktikë ku termi korrupsioni ligjor, as do që duket si oksimoron, e ka zbatimin e saj praktik.

Përkatësisht, një nga veprimet karakteristike të korrupsionit publik është pastrimi i parave në pajtim me nenin 273 të Kodit Penal. Paratë nga burimet ilegale investohen më së shumti në aktivitete ligjore, siç është shembulli i mësipërm, por edhe në shumë sektorë të tjerë, në mënyrën që këto fonde, nëpërmjet subjekteve tashmë juridike ekzistues ose të formuar, hyjnë në ekonomi dhe bëhen konkurrentët e saj. Pastrimi i parave në fakt është fazë dytësore e krimit të organizuar dhe korrupsionit, domethënë pasojë e tyre, që përfaqëson të ardhurat e fituara në mënyrë të paligjshme si ligjore. Këto flukse monetare janë të vështira për monitorimin dhe kontrollin të vazhdueshëm, pasi shpesh dimë të kalojnë kufijtë e shtetit dhe depërtojnë në tregjet e huaja.

4. KORRUPSIONI SI MËNYRË E JETËS

Problemi më i madh me të cilin përballen shoqëritë moderne është më shumë dimension psikologjik sesa social. Kërcënimi i shoqërive moderne është bashkëpunimi i fshehtë i njeriut me krimin e organizuar dhe veçanërisht korrupsionin. Infiltrimi i tepërt në të gjitha pikat e jetës së njerëzve shkakton korrupsionin të shihet përmes një prizmi të ndryshëm - si mjet për të lehtësuar jetën, jo si një e keqe që duhet çrënjësuar. Qytetarët në korrupsion gjejnë një partner ose një mënyrë më të lehtë dhe më të thjeshtë për t'i arritur qëllimet e tyre dhe kështu filluan të shohin korrupsionin si një mjet dhe jo si një problem që në afat të gjatë kërcënon të shkatërrojë shtetin dhe të gjithë mekanizmat e tij.

Në këtë kontekst, lidhet edhe një problem tjetër vjen që nga i lartpërmenduri, që është besimi minimal ose pothuajse jo i qytetarëve në institucionet e shtetit, dhe fajësia për këtë duhet padyshim të adresohet vetëm në një adresë: konfuzioni politik në të cilin gjendet shteti. Rrënjët e këtij përfundimi janë në praktikën e zbatimit të politikave me dyer të mbyllura pa ndonjë transparencë, dhe më e rëndësishmja prej të gjithave, në takimet e liderëve. Zgjidhjet më të rëndësishme dhe më të jashtëzakonshme në historinë e pavarësisë sonë, u miratuan në takimet e liderëve pa transparencë, të cilat pastaj zgjidhen vetëm nëpërmjet mekanizmave ligjorë të institucioneve të sistemit për të marrë një formë ligjore të shkruar.

5. KRITIKAT DHE UDHËZIMET E Z. RAINHARD PRIBE

Duke u përballur me skandalin politik më të madh deri më tani dhe korrupsionin brutal në Republikën e Maqedonisë, i cili ka gjasa të mbahet mend për një kohë të gjatë dhe pasojat e të cilit do të ndihen për një kohë të gjatë, i shprehur përmes ndjekjes ilegale të komunikimeve të më shumë se 20.000 qytetarëve, është shumë më tepër sesa një skandal i thjeshtë politik, por kjo paraqet një erozion të plotë të moralit, të etikës, ose në fund të ditës, dimensionit njerëzor apo asaj që ka mbetur te mbajtësit e pushtetit.

Ndryshimi i procedurës penale nga inkuizitore në akuzuese e imponoi parmin e pasivitetit në gjykatë, gjatë çka palët janë ato të cilat e kanë rolin kryesor në drejtim të vërtetimit të teorisë së tyre për rastin. Ngjashëm si me ndryshimet në mënyrën e marrjes në pyetje të dëshmitarëve me ndryshimin e LPP, është ndryshuar edhe mënyra e nxjerrjes së materialeve të provës, dhe tani të njëjtat prezantohen nga palët të cilat i propozojnë të njëjtat. Krahasuar me problematikën e përmendur paraprakisht në lidhje me rolin e


gjykatës gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe kujdesit për lejimin e pyetjeve dhe përgjigjeve, ashtu edhe gjatë nxjerrjes së materialeve të provës paraqitet mënyra jo konsekuente në lidhje me parimin e akuzimit, që është edhe një indikator për shkallën e suksesit të kalimit në model të ri të procedurës penale. Respektivisht, në 8 prej 9 rasteve provat materiale janë prezantuar me lexim nga gjykata, ndërsa vetëm në 1 rast të njëjtat janë prezantuar nga pala e cila i ka propozuar provat. (Shih grafikun më poshtë, majtas)



Nxjerrja e provave materiale me lexim dhe prezantimi nga gjykata.

Ajo që është shqetësuese është rritja e mprehtë e kësaj mënyre të paraqitjes së provave në vitin 2017, e cila është më shumë se e dyfishuar krahasuar me vitin 2016.


Mënyra e regjistrimit të seancës rregullohet me nenin 374 të LPP-së, sipas të cilave neni 1 dhe 2 "rrjedha e seancës kryesore regjistrohet me zë ose vizuale- tonike" dhe "në fillim të seancës, kryetari i këshillit informon palët e pranishme dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurën për atë që të incizohet seanca dhe se incizimi paraqet një regjistrim tonik ose vizual-tonik nga seanca e mbajtur." I njëjti nen në paragrafin 3 parasheh që "Kur nuk ekzistojnë kushte teknike për incizim të zërit ose vizual- tonike gjatë seancës kryesore, kryetari i këshillit mund të urdhërojë që për rrjedhën e shqyrtimit kryesor të mbahet procesverbal stenografik."




Mënyra e regjistrimit të seancës kryesore (e shprehur në përqindje)

Megjithëse ligji parashikon mbajtjen e procesverbalit si përjashtim në rastet kur nuk ka kushte për regjistrim, të dhënat tregojnë se një përjashtim i tillë në praktikë është

në fakt një rregull, ndërsa regjistrimi paraqitet si një përjashtim. Arsyeja e vetme për shkak të mospërputhjeve të tilla me ligjin është mungesa e pajisjes së regjistrimit në shumicën e sallave gjyqësore në Gjykatën Themelore Shkup 1 në Shkup dhe rritja e seancave ku regjistrimi bëhet me incizim është kryesisht për shkak të rritjes së numrit të seancave dëgjimore për rastet e ekspozuara në media që kryesisht mbaheshin në dy sallat e gjykatave më të mëdha¹⁵, të cilat në fakt janë të vetmet në të cilat ekzistojnë pajisjet audio dhe vizuale të regjistrimit. Ajo që inkurajon është më shumë nga rritje e dyfishtë në përqindjen e seancave ku procesverbali udhëhiqet me regjistrimin e drejtpërdrejtë të deklaratave. Edhe pse kjo do të thotë edhe më shumë se një reduktim i dyfishtë në seancat ku procesverbali diktohen nga gjyqtari, një mënyrë e tillë e regjistrimit është e dukshme në gati një të tretën e seancave të vëzhguara në 2017. Kështu, parafrazimi i pyetjeve dhe përgjigjeve nga gjyqtarët kur hyjnë në procesverbal mbetet një nga kritikant më të mëdha që Koalicioni të gjithë për gjykim të drejtë i ka në lidhje me regjistrimin e seancës kryesore.



Vallë mbrojtësi dhe prokurori janë trajtuar në mënyrë të barabartë nga gjyqtari në lidhje me ankesat, etj.



A kishte mbrojtja të njëjtat mundësi si prokuroria në propozimin e provave?

Nga paraqitjet grafike të mësipërme mund të përcaktohet trajtimi që ka marrë mbrojtja në raport me atë që ka prokuroria në procedurat penale në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Përkatësisht, ekzistojnë disa raste të trajtimit të pabarabartë në dobi të prokurorisë dhe kjo zakonisht është situata në të cilën pranohen provat e mëtejshme të propozuara nga prokuroria dhe të njëjtat i refuzohen mbrojtjes. Edhe pse në të dyja rastet nuk kishte dëshmi apo prova të reja që nuk mund të ishin sjellë para fillimit të procedurës, disa (PP) u refuzuan dhe të tjerët (të mbrojtjes) u pranuan.


7.6. Transparenca gjatë procedurave

E drejta për një gjykim të drejtë dhe të drejtë të parashikuar në nenin 6 të GjEDNJ-së përbëhet nga disa parime që duhet të përbushen për tu realizuar kjo e drejtë. Një nga këto parime është parimi i gjykimit publik që përfshin praninë e përfaqësuesve publikë

¹⁵ Një nga sallat e gjykimit është salla e Gjykatës Supreme që ishte caktuar për t'u përdorur për nevojat e rastit "Lagja e trimave" ku kishte 37 të akuzuar.

në seancë, në mënyrë për të siguruar pavarësinë në vendimmarrje, për të forcuar kontrollin civil mbi gjykatat si dhe për të rritur besimin e publikut në gjyqësorin.

Nëse shikojmë të dhënat nga dëgjimet e monitoruara, mund të vërehet se publiku ishte përjashtuar nga 8% e seancave të mbajtura. Edhe pse kjo përfaqëson një pjesë të vogël të numrit të përgjithshëm të rasteve të monitoruara, gjatë tre viteve të fundit, statistikat tregojnë një rritje të numrit të seancave të cilat ka qenë i përjashtuar publiku.




Publik i përjashtuar

Rritja e tillë në seancat dëgjimore të mbajtura pas dyerve të mbyllura është më së shumti rezultat i marrjes në pyetje të dëshmitarëve të rrezikuar, ose nxjerre të provave të klasifikuara. Edhe pse marrja në pyetje e dëshmitarëve të rrezikuar paraqet bazë ligjore për përjashtimin e publikut, ligjvënësi ka paraparë një sërë masash të tjera (neni 228 deri 232 i LPP) për mbrojtjen e dëshmitarëve, siç është fshehja e identitetit, marrja në pyetje përmes video lidhjes me fytyrë të turbulluar dhe ngjashëm dhe e gjitha kjo me qëllim të mundësohet përjashtimi i publikut të kryhet vetëm me përjashtim në rastet më të domosdoshme. Si një argument shtesë për rëndësinë e publikut në seancë është neni 355 f. 2 të LPP-së, sipas të cilit një gjykatë mund të lejojë praninë e publikut ekspert, domethënë punonjësve shkencorë dhe publikë në seancat ku publiku është i përjashtuar. Për fat të keq, kjo mundësi ligjore ende nuk është përdorur nga gjykata, gjë që lë përshtypjen se gjykatat në Maqedoni ende kanë keqkuptime në lidhje me praninë e publikut në seancën kryesore.

Veprimet e tilla të gjykatës lënë hapësirë për vlerësim të dobët të transparencës dhe llogaridhënies në procesin dhe vendimmarrjen e tyre. Kjo është edhe më problematike për shkak të mënyrës në të cilën publiku është i përjashtuar, kështu që këtë vit është vërejtur ky problem në 5 (pesë) raste kur vendimi për përjashtimin e publikut nuk është bërë në formë të aktvendimit dhe as nuk është shpallur publikisht, por thjeshtë policia gjyqësore pamundëson qasjen në sallën e gjyqit me arsyetimin se publiku është i përjashtuar nga dëgjimi.

Treguesi i transparencës së gjykatave është gjithashtu publikimi i të dhënave për lëndët që janë në punën e gjykatës, si dhe publikimi i kohës dhe vendit të gjykimit që duhet të shpallet publikisht në tabelën jashtë sallës së gjyqit. Këtu e konsiderojmë të rëndësishme të përmendet se që nga prilli 2017, gjykatat në Republikën e Maqedonisë


kanë faqe të reja të internetit, por tani ka më pak të dhëna për lëndët në punën e gjykatës pasi janë tërhequr të dhënat që ngarkohet për veprën penale. Nëse shihen të dhënat e tre viteve të fundit, ka një rënie të dukshme në aspektin e transparencës në vitin 2017, ku për herë të parë numri i seancave dëgjimore ku koha dhe vendi i mbajtjes nuk janë shpallur publikisht është më i madh se numri i seancave ku koha dhe vendi i seancave janë njoftuar publikisht.



Vallë vendi dhe koha e gjykimit ishin të shpallura publikisht në tabelën jashtë sallës së gjyqit

7.7. Parimi i paanshmërisë


Një nga parimet esenciale në kuadër të së drejtës për fer gjykim dhe procedurë të drejtë pa dyshim është parimi i pandashmërisë së gjyqësorit. Analiza e mbrojtjes së këtij parimi në procedurat gjyqësore ishte bazuar mbi një sërë çështje të cilat vlejné për përjashtimin e gjykatave, që pa dyshim është një nga mekanizmat në kushtet e anshmërisë së identifikuar të gjykatave ndaj ndonjë nga palët. Gjatë kësaj, nga seancat gjyqësore të mbikëqyrura, mbikëqyrësit kanë evidentuar gjithsej 3 raste gjatë së cilave është kërkuar për përjashtimi i gjykatësve. Në një nga rastet bëhej fjalë për gjykatës i cili paraprakisht ka marrë pjesë në procedurë penale, ndërsa në 2 raste të tjera mbikëqyrësit kanë shënuar në seksionin “ tjetër”, se është shkak i përjashtimit, që më vonë gjatë analizës së pyetësorëve ka rezultuar se bëhet fjalë për dyshime për veprim jo objektiv. Si përmbledhje, nga të dhënat e përpunuara mund të konstatojmë se gjykata, relativisht në mënyrë përkatëse i ka zbatuar dhe ka pasur kujdes në lidhje me dispozitat nëpërmjet të cilave në LPP është parashikuar përjashtimi i detyrueshëm i gjykatësve, si dhe se në masë të madhe në mënyrë përkatëse e ka udhëhequr procedurën gjatë kësaj pa lënë baza për dyshim për pa anshmërinë e tij, si bazë për përjashtimin fakultativ të gjykatësve.



Në lidhje me pyetjen, vallë vërehej se gjykatësi ose porota tani më kishin formuar mendim i cili mund të ndikonte mbi vendimmarrjen në procedurë konkrete, mbikëqyrësit kanë evidentuar vetëm 1 rast të këtillë. Në këtë rast konkret bëhet fjalë për person që është kthyer përsëri, kryerës i veprave penale për të cilin edhe vetë gjykatësit në këshill të cilët vendosin kanë konstatuar sepse paraprakisht pikërisht tek ata ka pasur lëndë, dhe në mënyrë konsekuente edhe konkluzë se është fajtor.

Gjatë periudhës së parashikuar për monitorim, në asnjë rast nuk është vërejtur përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjykata ndaj palëve në lidhje me gjininë e tyre, rasën dhe ngjashëm, ndërsa njëkohësisht nuk është konstatuar as përdorimi i frikësimit gjatë procedurave. Në drejtim të vëmendjes së merituar nga gjykata gjatë kohës kur është mbajtur procedura, të dhënat sugjerojnë në përqindje të lartë prej 93%, ndërsa në drejtim të barazisë procedurale të palëve gjatë procedurës, kemi të dhëna që sugjerojnë jo barazi në gjithsej 5 seanca gjyqësore. Kjo jo barazi zakonisht është në dobi të prokurorisë, ndërsa në drejtim të propozimit dhe pranimit të disa provave, si dhe mënyra e marrjes në pyetje të dëshmitarëve.

Komunikimi ex – partë jo përkatës, në masë të madhe mund të cenojë përshtypjen për (pa) anshmëri të gjykatës te i akuzuari ose te publiku në përgjithësi. Dhe, së këndejmi gjatë komunikimit jo përkatës ex - parte, gjykata rrezikon të pranohet si i afërt me ndonjë nga palët, me çka te publiku i gjerë humbet përshtypja për pa anshmërinë e tij. Ndonjëherë madje edhe avokatët e mbrojtjes përpiqen dhe/ ose e keqpërdorin këtë komunikim jo përkatës me gjykatën, me qëllim të lënë përshtypje të mirë të klientët e tyre. Perceptimi i mbikëqyrësve tonë, sugjeron në evidentimin e kësaj praktike në gjykatat në gjithsej 12 seanca (shih grafikun më poshtë), që realisht paraqet përqindje të madhe, por duke marrë parasysh faktin se e njëjta nevojitet tani më, të mënjanohet, kjo shifër megjithatë është alarmante.



7.8. Prezumimi i pafajësisë

Supozimin e pafajësisë, të përcaktuar si kategori e garantuar me Kushtetutë, LPP e parasheh në nenin 2, ku thuhet: “Personi i akuzuar për vepër penale, do të konsiderohet si i pafajshëm derisa faji i tij nuk përcaktohet me vendim gjyqësor të plotfuqishëm.”

Kjo kategori nëpërmjet prizmit të mbikëqyrësve tanë është respektuar në 98% të seancave të mbikëqyrura, të tjerat 2% të cilat sugjerojnë në mos respektimin e saj do ti kishim vendosur në kategorinë e gabimit eventual statistikor për shkak se qartë dhe në mënyrë koncize nuk është arsyetuar për se është fituar kjo përshtypje dhe perceptim nga mbikëqyrësi i cili e kanë mbikëqyrur këtë lëndë konkrete. Së këndejmi, nuk do ta evidentojmë si përjashtim nga zbatimi i kësaj rregulle për respektimin e prezumimit të pafajësisë për person të akuzuar.


7.9. E drejta e mbrojtjes

E drejta e mbrojtjes si e drejtë esenciale e të akuzuarit ishte analizuar nëpërmjet një sërë çështje në lidhje me vërejtjet për të drejta të caktuara kryesore të të akuzuarit, efikasitetin e mbrojtësve në realizimin e teorisë për rastin gjatë seancës kryesore si dhe në mundësinë për ofrimin e mbrojtjes përkatëse dhe cilësore, qasjen e mbrojtjes drejt të gjitha provave, koha përkatëse për përgatitje dhe ngjashëm.

Në drejtim të efektivitetit nga e drejta për mbrojtje, mbikëqyrësit tanë vërejtën se në 3% të seancave të mbikëqyrura, mbrojtësit nuk i janë përgjigjur në mënyrë përkatëse detyrës së tyre për sigurimin e mbrojtjes efikase dhe profesionale për klientët e tyre. Në bazë të kësaj informate, e cila sugjeron përqindje relativisht të ulët të numrit të përgjithshëm të lëndëve të mbikëqyrura, megjithatë, duhet përmendur se mbrojtësit, or edhe vetë profesioni i mbrojtësve i përfaqësuar nga OARM-së si fushë profesionale, është e obliguar të kujdeset për sigurimin e trajnimeve të vazhdueshme dhe avancimin e standardeve profesionale të anëtarëve të saj. Dhe, më se e nevojshme është të zbatojnë analiza të vazhdueshme dhe vlerësime për efikasitetin dhe profesionalitetin e

mbrojtësve¹⁶, në veçanti pas vendosjes së sistemit të akuzave, në të cilin nga veprimet të cilat i ndërmerr mbrojtja gjatë seancës kryesore, në masë të madhe varet edhe epilogu përfundimtar i procedurës penale.

Si një nga argumentet për mbrojtjen jo përkatëse të mbrojtësve theksohen koha për përgatitjen e mbrojtjes, respektivisht nëse ekzistimi i ndonjë lloj restriksioni në lidhje me kohën të cilën e ka pasur mbrojtja. Kështu, gjatë përpunimit të të dhënave hasëm në informatën se në 31% të seancave të monitoruara (pasqyrimi grafik më poshtë në të majtë), mbrojtësit janë ankuar në lidhje me kohën që e kanë pasur në dispozicion për përgatitjen e mbrojtjes së klientëve të tyre. Ndërkaq në 8% të seancave të mbikëqyruara, mbrojtësit kanë reaguar në qasjen e kufizuar drejt të gjitha provave. Paraqitja grafike poshtë në të djathtë).



Kjo aludon në faktin se qëllimet e pritura në lidhje me procedurën penale¹⁷ nëpërmjet miratimit të LPP në vitin 2013, nuk zbatohen në mënyrë praktike, dhe në mënyrë konsekuente do të duhet të mendohet për ndryshimin e dispozitave të LPP, në drejtim të inkorporimit të mekanizmave garantues për mbrojtësin në drejtim të përforcimit të obligimit për qasje drejt të gjitha provave të prokurorisë që mund ti sigurojë edhe mbrojtja.

Përmirësime dhe ndryshime në këto praktika do të bëhen të mundura nëpërmjet vendosjes eventuale të ndalimit për nxjerrjen e provave të cilat nuk kanë qenë të qasshme

¹⁶ Rëndësia e rolit të mbrojtësve gjatë procedurës penale akuzuese, dhe në veçanti gjatë procedurës për marrëveshje është apostrofuuar nëpërmjet më shumë hulumtimeve empirike që në vitet 70 të shek. të kaluar në SHBA dhe Angli – shih më tepër shembuj te: Albert Alschuler, The Defense Attorney 's Role in Plea Bargaining, 84 Yale Law Journal 1179 (1974); Baldwin J. & McConville M., Negotiated justice: pressures on defendants to plead guilty, London: Martin Robertson, 1977. Ose për hulumtime më moderne shih: McConville, Mike, Plea Bargaining: Ethics and Politics, pp. 562-587, Journal of Law and Society, Vol 25, No. 4, 1998; Yue, Ma, Prosecutorial Discretion and Plea Bargaining in the USA, Germany, France and Italy: A Comparative Perspective, International Criminal Justice Review, 2002, 12, 22


¹⁷ Krapac D., Kambovska V. Buzharovska G., Kallajxhiev G., Strategjia për reforma në të drejtën ndëshkuese Ministria e Drejtësisë, Shkup, 2007 e qasshme në: http://arhiva.vlada.mk/registar/files/strategjia_kazneno.pdf

respektivisht nuk u janë dorëzuar mbrojtësve, ndërkaq gjatë kësaj të njëjtat janë në dëm të të akuzuarit.

Atë për të cilën marrim të dhëna pozitive, për habi, është fakti se gjatë asnjë seance ku i akuzuari ka përdorur të drejtën e tij të mbrohet me heshtje, gjykata nuk ka nxjerrë përfundime negative nga shfrytëzimi i kësaj të drejte.

Në drejtim të udhëzimit për të drejtën për ndihmë juridike falas, ende ballafaqohemi me përqindje të pa kënaqshme në lidhje me zbatimin e kësaj praktike nga gjykata. respektivisht, në vetëm 50% të seancave të mbikëqyrura, mbikëqyrësit kanë vërejtur se i akuzuari është udhëzuar në lidhje me këtë të drejtë, përkundër përqindjes të njëjtë, të të akuzuarve të cilët nuk kanë marrë asnjë udhëzim. Mirëpo, nëse merret parasysh fakti se bëhet fjalë për lëndë nga fusha e krimin dhe korrupsionit. në të cilat, të akuzuarve me vetë atë që bëjnë pjesë në këtë kategori ju kërcënohen dënime më serioze për vepra penale, dhe që nga fillimi të njëjtit angazhojnë mbrojtësit e tyre, që në fazën e procedurës paraprake, supozim legjitim është se të akuzuarit në këto 50% të seancave, ku nuk janë udhëzuar për të drejtën e ndihmës juridike falas, kishin siguruar mbrojtësin e tyre që më herët.

Mundësia i akuzuari të ketë dhe ti sigurohet mbrojtje përkatëse gjatë një procedure gjyqësore, ngushtë është e lidhur me komunikimin me aktorët të tjerë gjatë procedurës, fillimisht me mbrojtësin e tij, dhe më pas edhe me gjykatën respektivisht përfaqësuesin e palës paditëse, si dhe dëshmitarët eventuale dhe provat të tjera gjatë procedurës. Në kushte të mungesës së komunikimit dhe mbrojtjes të cilën i njëjti do ta ketë dhe do ta shprehë, nuk do të mund të arrihet efekti i dëshiruar. Kështu gjuha në të cilën udhëhiqet procedura nëse i akuzuari nuk e njeh ose e njeh në masë të konsiderueshme, është kusht të sigurohet përkthyes përkatës ose interpretues nëse ka nevojë. Në këtë drejtim, në kuadër të pyetësorit ishin parashikuar edhe pyetje të cilat kanë të bëjnë me këtë vegël të rëndësishme për komunikim – gjuha. Edhe atë - pyetje nëse i akuzuari ka pasur nevojë për përkthyes, nëse i është siguruar dhe nëse kjo ka ndodhur menjëherë ose me prolongim. Gjatë përpunimit të të dhënave, arritëm në konstatimin se nga gjithsej 52 të akuzuar, të cilët janë pyetur në lidhje me nevojën për përkthyes gjatë procedurës, 11 vetave nuk u është dashur përkthyes, 39 vetave u është siguruar përkthyes menjëherë gjatë fillimit të seancës, ndërsa dy vetave u është siguruar përkthyes në mënyrë plotësuese. Mund të vërehet edhe në grafikun më poshtë. Por, këtu është me rëndësi të përmendet se nga mbikëqyrësit, është vërejtur prolongimi i seancave për shkak të mungesës së përkthyesit.



Si element i rëndësishëm i mbrojtjes efektive, dhe në lidhje me të drejtën për përkthyes, e hulumtuam edhe kompetencën respektivisht (jo) anshmërinë eventuale të përkthyesit respektivisht interpretuesit, kështu kemi arritur deri te informata se vetëm në një lëndë respektivisht në një seancë është reaguar në lidhje me këtë rrethanë. Në atë rast konkret, mbrojtësit kanë qenë ata që kanë reaguar në lidhje me cilësinë e përkthimit.

7.10. Shqiptimi dhe publikimi i aktgjykimit

Pas nxjerrjes së të gjitha provave, respektivisht pas përfundimit të procedurës së provave dhe pas përfundimit të seancës kryesore, në pajtim me LPP në mënyrë rrjedhimore vijnë dispozitat të cilat vlejnë për aktgjykimin. Ligji jonë për procedurë penale, njeh 3 lloje të aktgjykimit, edhe atë: refuzuese - me të cilën akuza refuzohet, çliuese – me të cilën i akuzuari lirohet nga akuza dhe i dënuar – me të cilën i akuzuari shpallet fajtor. Mbikëqyrësit e Koalicionit kanë detektuar aktgjykime refuzuese dhe për lirim, por prandaj të gjitha 9 aktgjykimet për të cilat është vendosur gjatë periudhës së parashikuar për mbikëqyrje janë aktgjykime me dënim.

7.11. Politika dënuese në aktgjykimet e shpallura publike

Dispozitat e LPP parashohin aktgjykimi të shpallet në mënyrë publike menjëherë pas shqiptimit të tij, me atë që nëse gjykata nuk ka mundësi të njëjtën ta shqiptojë ditën e njëjtë pas përfundimit të seancës, ta prolongojë edhe publikimin e akt gjykimit, por më së shumti deri në 3 ditë. Publikimi i aktgjykimit është parashkruar të kryhet nga gjykata (kryetari i këshillit ose gjykatës individ) në prezencë të palëve, përfaqësuesve të tyre ligjor, të autorizuar, mbrojtës, gjatë çka shqiptimi i të njëjtës lexohet publikisht dhe shkurt tregohen shkaqet për miratimin e të njëjtës. Në arsyetimin e shkurtë, gjykata jep vështrim në lidhje e veprën penale për të cilën ngarkohet dhe është dënuar (me aktgjykim) i akuzuari, si dhe në lidhje me provat e prezantuara.

Të dhënat nga mbikëqyrja e realizuar sugjerojnë në 10 lëndë të përfunduara, prej të cilave 2, janë kryer në procedurë të rregullt me zbatimin e të gjitha segmenteve të procedurës, në 2 procedurat janë realizuar dhe aktgjykimet janë shpallur në mungesë të të akzuarit, 5 janë përfunduar për shkak të pranimit të fajit dhe për një lëndë procedura është ndërprerë për shkak se lënda është parashkruar.

Konkretisht në një nga lëndët të cilat janë përfunduar në mungesë të të akuzuarit, gjykata ka publikuar se akt gjykimin palët do ta fitojnë në procedurë plotësuese, që do të thotë pa shpallje publike të aktgjykimit. Në lëndën e dytë i gjykuar në mungesë, i pari i akuzuar fitoi dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 vjet dhe 6 muaj, ndërsa 6 personat të tjerë fituan dënim me kusht.

Sa i përket lëndëve në lidhje me pranimin e fajit, 5 vendime 3 janë shpallur publikisht, kështu, një prej tyre, nga 4 të akuzuar, për dy të akuzuarit ju është shqiptuar dënim me burg, ndërsa dy të tjerëve dënim me kusht, me atë që është përcaktuar edhe konfiskim i pronës në vlerë prej mbi 500.000 den. dhe konfiskimi i sendeve, në lëndë tjetër të akuzuarit i është shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 vjet në lëndën e tretë dënim me burg prej 4 vjet dhe 3 muaj me dëbimin e shtetasit të huaj nga vendi në kohëzgjatje prej 5 vjet dhe marrjen e sendeve të konfiskuara.

Dhe për fund akt gjykimet për lëndët të cilat janë udhëhequr pothuajse 3 vjet, gjatë së cilave personat e akuzuar ishin të akuzuar në pajtim me nenin 394 - a paragrafi 2 për " Veprim terrorist", dhe 394-b paragrafi 1 për "Terrorizëm" nga Kodi penal i R. së Maqedonisë, në njërin cili udhëhiqej si procedurë e veçuar, i akuzuari është dënuar me dënim të përjetshëm me burg, ndërsa lënda tjetër 13 të akuzuar u dënuan me 40 vjet burg, 6 të akuzuar u dënuan me 20 vjet burg, 1 i akuzuar u dënua me 18 muaj burg, 2 të akuzuar u dënuan me 14 vjet burg, 2 të akuzuar u dënuan me 13 vjet burg dhe 2 të akuzuar u dënuan me 14 vjet burg. Në pajtim me nenin 33 të Kodit penal gjykata gjithashtu të gjithë shtetasve të huaj ju gjykoi edhe dënim dëbim i shtetasit të huaj, përgjithmonë, nga territori i R. së Maqedonisë.

Gjatë shpalljes të aktgjyimeve, është evidentuar se vetëm në 50% të rasteve, gjykata iu referua veprës penale me të cilën i akuzuari ngarkohet dhe në prezantimin e fakteve.

Ndërsa në lidhje me kushtet për ankesë, si pjesë e rëndësishme e procedurës pas shpalljes së aktgjykimit, në pajtim me nenin 406 të LPP, dhe të cilat janë obligim në bazë të ligjit, sipas të cilit obligim gjykata duhet menjëherë pas shpalljes së aktgjykimit kryetari i këshillit ose gjykatës) ti udhëzojë palët për të drejtën e ankesës, si dhe për të drejtën e përgjigjes ndaj ankesës, do të përmendim se vetëm në një nga këto lëndë të përfunduara, gjykata nuk e ka udhëzuar të akuzuarin për kushtet për ankesë. Nëse eventualisht është shqiptuar dënim me kusht, gjykata ka obligim të tërheqë vëmendjen në lidhje me rëndësinë e dënimit të kushtëzuar dhe kushtet të cilat duhet ti respektojë i akuzuari, tani më i dënuar.

8. LËNDË GJYQËSORE TË PROFILIT TË LARTË

Në këtë pjesë të kësaj analize, do të përfshihen lëndë gjyqësore të profilit të lartë, të cilat janë udhëhequr vitin e kaluar në Gjykatën Themelore Shkup 1 në Shkup, ndërsa të cilat Koalicioni me mbikëqyrësit e saj i mbikëqyrte në vazhdimësi. Theksojmë se në disa raste të këtyre lëndëve ishte detektuar zbatim jo konsekuent i dispozitave të LPP, për çka Koalicioni nëpërmjet sistemit të vendosur për zbulimin e hershëm dhe raportimin në lidhje me mangësitë, raportoi nëpërmjet ueb faqes së saj. Lëndët të tjera, në të cilat nuk janë vërejtur shkelje esenciale të parimit të gjykimit të drejtë, si dhe të dispozitave të Ligjit për procedurë penale, në pjesën e analizës e cila vijon, do të kenë vetëm arsyetim të shkurtë për veprën penale dhe narracion të shkurtë të përmbledhur nga seancat e mbikëqyrura gjatë vitit të kaluar. Në vazhdim do të japim vështrimin tonë në lidhje me procedurat.

8.1. “Komuna Qendër”

Në këtë lëndë, 15 persona ndër të cilët edhe ish kryeministri, dhe tani lider i opozitës, u akuzuan për keqtrajtim, ofendim të rëndë, cenimin e sigurisë respektivisht dhunë të ashpër me çka në publik kanë shkaktuar ndjenjë të pasigurisë, cenim ose frikë respektivisht "Dhunë" sipas nenit 386 paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 1 i nenit 23 të Kodit penal të Republikës së Maqedonisë, por kishte edhe persona të akuzuar për nxitje me paramendim për kryerjen e veprës penale të lartpërmendur. Në mesin e këtyre 15 të akuzuarve, u gjetën edhe anëtarë të lartë të partisë VMRO – DPMNE dikur parti qeveritare, të cilët në fakt ishin edhe bartës të funksioneve publike.

Në lidhje me këtë lëndë, u mbajt seancë gjyqësore për vlerësimin e provave, seancë gjyqësore për përgatitjen e seancës kryesore, mirëpo ajo që "kapërcye" ishte seanca kryesore sipas Ligjit për procedurë penale është parashikuar të mbahet, nëse merret parasysh vepra penale neni 386 paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 1 neni 23 i Kodit penal të RM-së. Në pajtim me Kodin penal të RM-së bëhet fjalë për vepër penale për të cilën është parashkruar dënim me burg prej 3 muaj deri në 3 vjet, dhe së këndejmi edhe veprimi i gjykatës në lidhje me propozimin për akuzë, por edhe procedurën e shkurtuar me gjykatës individ. Ajo që shqetësonte në veçanti gjatë një prej seancave dhe që ishte habitëse, dhe në veçanti edhe e pa qartë është aspekti teorik i zbatimit të LPP, është fakti se nuk u mbajt seanca kryesore por është bërë përgatitje për seancën kryesore me vlerësimin e provave.

Neni 476 i LPP parasheh se – meqë bëhet fjalë për propozim për akt akuzë dhe së këndejmi edhe automatikisht procedura e shkurtuar "gjykatësi i thërret në seancë kryesore: të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij, paditësin, të dëmtuarin dhe përfaqësuesit e tij ligjor dhe të autorizuar, dëshmitarët, ekspertë dhe interpretuesin". Kjo rrjedhë ligjore e veprimeve është parashikuar në nenin 480 të LPP dhe të cilat janë në lidhje me dispozita në pjesën e Procedurës së shkurtuar - e cila thotë se "seanca kryesore fillon me nxjerrjen

përmbajtjes së aktakuzës, ndërsa seanca kryesore e filluar do të përfundojë, me mundësi pa ndërprerje".

Në lidhje me konfuzionin e lartpërmendur ndërmjet kësaj që e parasheh ligji dhe interpretimin e gjykatës, ndërliidhen edhe ftesat të cilat atëherë iu paraqitën PSP-së dhe mbrojtjes, ndërsa të cilat sipas dispozitave të theksuara në to, por edhe udhëzimeve juridike, pa dyshim vlejné si ftesa për seancën gjyqësore kryesore. Megjithatë, gjykata iu qas zbatimit të nenit 345 paragrafi 2 të LPP - "Kryetari i këshillit fton palët të vinë në ditë të caktuar në gjykatë që të arsyetojnë propozimet e tyre, respektivisht ankesa në lidhje me provat e paraqitura", të cilat dispozita përsëri sugjerojnë në procedurë të rregullt, dhe jo në procedurë të shkurtuar.

Gjykata gjatë veprimit të saj i zbaton edhe dispozitat e nenit 347 të LPP i cili parasheh kushte për refuzimin e provave të propozuara. Për disa propozime ose prova të paraqitura nga PSP, gjykata vendosi të pranojë ankesën e mbrojtjes, dhe kështu miratoi vendim për procedim për refuzimin e propozimit për dëshmitar të rrezikuar, por edhe refuzimin e provave – audio incizime nga bisedat telefonike në të cilat bazohet akuza.

Atë që duam ta theksojmë është se në kapitullin për dëshmitarët, LPP parasheh mbrojtjen e dëshmitarit të rrezikuar gjatë seancës kryesore. Mënyra e propozimit të këtij dëshmitari dhe dispozitat të cilat vlejné për atë janë parashikuar në nenin 228 të LPP, por në rastin konkret sepse nuk është mbajtur seanca gjyqësore kryesore siç është parashikuar me ligj (sipas procedurës së shkurtuar) me shkrim i arsyetuar propozimi për mënyrën e veçantë të hetimit të dëshmitarit të rrezikuar, PSK në zarf të vulosur e paraqiti në gjykatë. Më pas, është parashikuar gjykata të vendosë në lidhje me propozimin e prokurorit publik me aktvendim të cilin është i obliguar ta paraqesë më së voni në afat prej 8 orë nga pranimi i propozimit. Gjykata këtë e bën që në seancën e njëjtë, pas pauzës së shkurtë me tërheqjen e gjykatësit që bën gjykimin për të analizuar provat dhe ankesat, mirëpo me aktvendim procedues, mbi të cilin PSP nuk ka të drejtë të ankesës (në pajtim me nenin 228 paragrafi 3 – kundër vendimit të gjykatës nuk lejohet ankesë).

Për këtë lëndë nga mbikëqyrësit tanë është vërejtur edhe një seancë e shoqëruar me veprim kontrovers nga gjykata. Respektivisht, gjatë një seance gjyqësore, gjykatësja e cila e udhëheq këtë lëndë gjatë seancës u akuzua nga përfaqësueset e PSP për kryerjen e "falsifikimit intelektual" ose me fjalë të tjera kryerjen e veprës penale "Falsifikimin e dokumentit zyrtar" ndërsa kjo për shkak të faktit se përmbajtja e procesverbalit nga seanca e kaluar i cili i është dorëzuar PSP-së nuk korrespondon me përmbajtjen e konstatimeve të shprehura nga palët gjatë procedurës, ndërsa të cilat janë evidentuar në incizimin audio - vizual. Për këtë qëllim PSP nga gjykata e kërkoj incizimin audio - vizual i cili ishte evidente se ende nuk ishte i qasshëm për këtë prokurori që të përcaktohet shkëlja, dhe me këtë edhe kundër gjykatësi të lëndës të ngrihet procedurë penale përkatëse.

Ligji për procedurë penale në nenin 374 parasheh se një nga mënyrat në të cilat mbahen procesverbalet e seancave gjyqësore është incizimi vizual dhe me zë, por gjithashtu edhe në paragrafin 7 të këtij neni parashihet se palët dhe i akuzuari, kanë të

drejtë pas mbajtjes së seancës kryesore të fitojnë kopje nga incizimi vizual dhe me zë, në formë të shtypur dhe elektronike. Kopje nga ky incizim paraqitet menjëherë, dhe më së voni në afat prej 24 orë. Pse deri në atë moment PSP nuk morri kopje të incizimit, por vetëm procesverbal, nuk është e qartë. Ku qëndrim akuzues i PSP-së ndaj gjykatës dhe kërkesa tu jepet një kopje e incizimit, të cilin patjetër deri atëherë është dashur tu dorëzohet, ishin shkak të dy prokurorët të PSP të dënohen me para, edhe atë me dënim në shumë prej 2.000 euro nga gjykata, me arsyetimin se ato nuk e kanë respektuar gjykatën.

Ajo që në fakt është më interesante në gjithë veprimin, është fakti se gjykatësja ka vendosur pas dënimit të prokurorëve, të gjithë lëndën me të gjitha shkresat ti dërgojë në Këshillin e Prokurorëve Publik, gjatë kësaj, me dërgimin e lëndës në Këshillin e Prokurorëve Publik, e drejta e prokurorëve të paraqesin ankesë në lidhje me këtë aktvendim është vënë në pikëpyetje, sepse Këshilli i parashikuar me Ligjin për procedurë penale, në Gjykatën themelore, duhet të vendosë në lidhje me ankesën e tyre, dhe kjo nënkupton edhe lënda faktikisht të jetë e qasshme në gjykatë. Kjo tërheq më shumë pyetje nga aspekti i përgjegjësisë. Respektivisht, nga njëra anë LPP në nenin 88 paragrafi 3 parashihet se për dënimin e prokurorit publik, gjykata do ta njoftojë prokurorin publik kompetent, të Prokurorisë publike, ndërsa nga ana tjetër në nenin 7 paragrafi 3 të Ligjit për prokurori publike për ndjekjen e veprave penale në lidhje dhe të cilat dal nga përmbajtja e ndjekjes jo ligjore të komunikimeve, është parashikuar se Prokurori publik do të jetë profesionalisht përgjegjës për veprimet profesionale dhe ligjore gjatë punës së tij / saj para Këshillit të Prokurorëve Publik. Që do të thotë se gjykata ka obligim të njoftojë prokurorin publik kompetent të prokurorisë në këtë rast prokuroren speciale publike Katica Janeva dhe jo Këshillin e Prokurorëve Publik. Dhe, në veçanti nëse merret parasysh fakti se këtij Këshilli, kjo prokurori i përgjigjet vetëm profesionalisht për veprimet profesionale dhe ligjore të cilat i ndërmerret, që në asnjë rast nuk nënkupton – përgjegjësi për kryerjen e punës së saj (detektimin e bazave për dyshim për eventualisht / kinse kryerjen e veprës penale).

Nëse intenca e gjykatës me paraqitjen e të gjitha shkresave të lëndës në Këshillin e Prokurorëve Publik, ishte të ngrihet ndonjë lloj përgjegjësie disiplinore ndaj prokurorëve të PSP-së, e njëjta as që është e bazuar mbi ligj, as mbi rregulloren e dedikuar për përcaktimin e përgjegjësisë të prokurorëve publik. Si mbështetje për këtë paragraf ndërlihet neni 8 i kësaj Rregullore, i cili sugjeron në atë se saktë, kush paraqet propozim për ngritjen e procedurës për përgjegjësi disiplinore dhe në cilat raste. Në asnjë nga këto pika të këtij paragrafi nuk është përfshirë Prokuroria Speciale Publike, dhe aq më pak me këtë rregullore është parashikuar gjykata të ndërpresë iniciativën për ngritjen e procedurës për përgjegjësi disiplinore. Gjatë procedurave për përgjegjësi disiplinore të akuzuarit, formohet Komision (i cili në fakt vendos për përgjegjësinë disiplinore) dhe më pas, në shkallë të dytë vendos Këshilli i Prokurorëve Publik. Që do të thotë se edhe të ketë kompetencë Komisioni ose Këshilli të vendosin për përgjegjësinë disiplinore të prokurorëve të PSP-së gjykata ka obligim të njoftojë vetëm prokurorin publik kompetent

të prokurorisë konkrete kur do të ndodhë të dënohet prokuror publik gjatë procedurës penale. Kjo lëndë ende po vazhdon.

8.2. “Kalaja 2”

Në rastin konkret bëhet fjalë për lëndë në të cilën akuzën e përfaqëson PSP, ndërsa e njëjta është kundër shtatë të punësuarve të DSK për shkatërrimin e dokumentacionit në lidhje me sistemet nga ndjekja jo ligjore, të cilët konsiderohen si vepër e kryer penale "Falsifikim i dokumenteve zyrtare" nga neni 361 të Kodit penal të Republikës së Maqedonisë. Të punësuarit në DSK janë akuzuar për shkatërrimin e 2.047 shkresave zyrtare prej të cilave 22 në lidhje me sistemet për ndjekjen e komunikimeve.

Që në seancën përgatitore gjykata urdhëroi Prokurorinë Speciale Publike të drejtohet në Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave të Klasifikuara dhe MPB për sqarim plotësues rreth kërkesës së PSP për përdorimin gjyqësor të provave të cilat konsiderohen si informata të klasifikuara.

Klasifikimi i informatave dhe nxjerrja e tyre në gjykatë sipas Ligjit për procedurë penale nuk kontestohet aspak nëse të gjithë pjesëmarrësit në procedurë kanë siguruar certifikatë sigurie, që të njëjtit ta pranojnë përmbajtjen nga këto informata, në fakt për këtë ekziston procedurë ligjore - certifikata lëshohet për shkallë të caktuar të informatave të klasifikuara me kërkesë me shkrim nga person i interesuar juridik ose fizik, në adresë të Drejtorisë, ndërsa lëshimit të certifikatës i paraprin kontroll i sigurisë. Ajo që paraqet një nga specifikat gjatë veprimit në lidhje me këtë lëndë është fakti se gjykata e angazhoj PSP- në të kërkojë nga Drejtoria de klasifikimin e të dhënave. Neni 16 i Ligjit për informata të klasifikuara parasheh se klasifikimi i informatave pushon në disa situata të numëruara në mënyrë taksative, si për shembull: në datën e shënuar në dokument, me ndodhjen e ndonjë ngjarje të caktuar të shënuar në dokument, me skadimin e afatit kohor të shënuar në dokument dhe me de klasifikim. Mirëpo, de klasifikimi si mekanizëm i parashikuar me këtë ligj shkon deri në shkallë që parasheh vetëm se me të njëjtën kryhet ndryshimi i informatave të klasifikuara në informata të cilat ka qasje të lire (Neni 17). Dhe të njëjtën e kryen, krijuesi i informatës për çka i informon përdoruesit e informatës. Ky përcaktim i ngushtë i këtij mekanizmi as që jep liri për interpretim, as mundësi siç pritet kjo nga PSP-ja, kush do qoftë të kërkojë nga DSK të kryejë çfarë do lloj de klasifikimi të të dhënave respektivisht informatave të cilat do të përdorshin gjatë procedurës. Intenca evidente e ligjdhënësit gjatë miratimit të këtij ligji ka qenë kjo të vendoset në dispozitivin e vetë Drejtorisë, në rastin kur, dhe për se të ketë nevojë për atë, por edhe sipas iniciativës individuale, që është evidente. Me qëllim të evitohen prolongimet e mëtutjeshme të seancave dhe keqpërdorimi i institutit “certifikatë e sigurie” dhe zbatimin e tij respektivisht, posedimin, gjykata duhej të urdhëronte të gjithë mbrojtësit pjesë e procedurës, të sigurojnë certifikatë të sigurisë, që të mund të veprojnë respektivisht të mund ti mbrojnë klientët e tyre - të akuzuarit. Në këtë mënyrë do të evitohet prolongimi i mëtutjeshëm i seancave për “rishqyrtimin e provave” respektivisht seanca përgatitore të cilët edhe ashtu në bazë të ligjit në procedura të shkurtuara nuk janë parashikuar.

Edhe një moment kontestues në këtë procedurë, dhe në drejtim të publicitetit të procedurave në një nga seancat ishte edhe ajo që gjykata e përjashtoi publikun për shkak të shqyrtimit të korrespondencave në procedurën dhe gjykatën (në rastin konkret të PSP-së të gjykata).

Nëse publiku ishte përjashtuar për “shkaqe sigurie” nga aspekti i ndjeshmërisë së përmbajtjes së shkresave respektivisht kinse përmbajtjes së “klasifikuar” të të njëjtave, për shkak të mos pasjes së legjitimitetit (për nevojat e procedurës), shtrohet pyetja si iu lejua prezenca në gjykatë mbrojtëses e cila nuk ka certifikatë sigurie?! Megjithatë, kur ekzistojnë informata të klasifikuara, ato janë të klasifikuara pa marrë parasysh vetinë e personit pra të cilit nxirren nëse në çdo rast, personi nuk ka certifikatë sigurie.

Edhe në këtë rast është detektuar përjashtim i pa bazuar i publikut nga shqyrtimi dhe kjo me kërkesë të një nga avokatët mbrojtës, për shkak të leximit të korrespondencës nga MPB për PSP. Për këtë vendim të gjykatës është vërejtur reagimi nga përfaqësuesja e PSP sepse nuk bëhet fjalë për dokument të klasifikuar dhe nuk ka nevojë të largohet publiku, por megjithatë i njëjti u përjashtua.

Një ndër provat më të rëndësishme verbale të nxjerra në këtë lëndë, janë deklaratat e dëshmitarëve të cilët u morën në pyetje, ndërkaq të cilët konfirmuan se komisioni i Drejtorisë së Pestë në bazën sekrete të quajtur "Brest" në Petrovec të Shkupi ka shkatërruar materiale të cilat kanë qenë të DSK, por të njëjtit nuk ishin të njoftuar me përmbajtjen e tyre.

Dy nga të akuzuarit në këtë lëndë periudhë të caktuar kohore ishin në arrati, dhe mbasi të njëjtit pas flet arrestit të lëshuar ndërkombëtar u kapën në shtetin fqinj, më 02.11.17, mbrojtësi i të akuzuarve dha propozim seanca të prolongohet për afat kohor të pa përcaktuar, për shkak se akuzuari tani më është përcaktuar ku ndodhet dhe i njëjti gjendet në paraburgim për ekstradim në lidhje me kërkesën për ekstradim të Ministrisë së Drejtësisë, dhe së këndejmi nuk duhet të gjykohet në mungesë. Ky propozim has në kundërshtim nga PSP sepse i akuzuari ende nuk ishte i qasshëm për organet maqedonase të jurisprudencës, ndërsa edhe në rast se i akuzuari mungon, çdo herë procedura ka mundësi të përsëritet në prezencë të tij. Ky propozim i mbrojtjes u refuzua me aktvendim gjyqësor, ndërsa për shkak se i njëjti vlerësoi se nuk ekzistojnë kufizime ligjore në Konventën Evropianë dhe Ligjin për ndihmë ndërkombëtare në materien penale në lidhje me procedurën penale kur për të akuzuarin ka procedurë për ekstradim, kështu procedura vazhdoi me nxjerrjen e provave në plotësim të procedurës vërtetuese, ku publiku ishte i përjashtuar për shkak të nxjerrjes së provave të klasifikuara

Gjatë kohës së finalizimit të kësaj analize, për këtë rast u shqiptua dhe u shpall publikisht aktgjykimi me të cilin i pari i akuzuar është dënuar në mungesë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 vjet e 6 muaj ndërsa të akuzuarit të tjerë fituan dënime me kusht.

8.3. “Lagjja e trimave”

Lagja e trimave është lëndë e cila titullin e punës e fitoi sipas vendndodhjes gjeografike ku u zhvillua kryerja e veprës, ndërsa për të njëjtën ngjarje 33 persona u akuzuan për vepra penale të kryera në pajtim me nenin 394 – a paragrafi 2 për "Veprim terrorist" dhe 394 -b paragrafi 1 për "Terrorizëm" nga Kodi penal i R. së Maqedonisë.

Kjo lëndë, duke pasur parasysh faktin se ishte ndjekur nga afër nga i gjithë publiku profesional dhe jo profesional, ishte ndoshta një nga lëndët e rralla të cilat u zhvilluan si lëndë shkollore për lëndë nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit, në të cilin kishte zbatim konsekuent të dispozitave të LPP. Nuk ishin evidentuar lëshime dhe parregullsi, përpos disa herë ndoshta nuk është arsyetuar sa duhet izolimi i publikut nga seancat gjyqësore. K është një nga lëndët më të mbyllura të mbajtura në gjykatën penale, kjo për shkak të llojit të provave të cilat u paraqitën gjatë procedurës – dëshmitarë të mbrojtur.

Për shkak të faktit që kjo lëndë udhëhiqej më shumë se 2 vjet, si dhe për shkak të faktit se u mbajtën numër i madh i seancave- disa prej tyre të hapura për publikun, por pjesa më e madhe jo duke e pasur parasysh vëllimin e lëndës, në vazhdim do të paraqesim vetëm epilogun e tij.

Deri në momentin e përpilimit të kësaj analize, për lëndën u morr dhe publikua aktgjykimi me të cilin: Tridhjetë e tre të akuzuar u shpallën fajtor, ndërsa katër prej tyre u liruan nga akuza sepse prokuroria gjatë kësaj procedure nuk arriti të provojë akuzën për ata. Shtatë të akuzuarve iu gjykua dënim me burg të përjetshëm, tridhjetë të akuzuar u dënuan me burg në kohëzgjatje prej 40 vjet, gjashtë të të akuzuar u dënuan me burg në kohëzgjatje prej 20 vjet, ndërsa një i akuzuar të akuzuar u dënuan me burg në kohëzgjatje prej 18 vjet. Dy të akuzuar u dënuan me burg në kohëzgjatje prej 14 vjet, dy të akuzuar u dënuan me burg në kohëzgjatje prej 13 vjet, dhe dy të akuzuar u dënuan me burg në kohëzgjatje prej 12 vjet. Në pajtim me nenin 33 të Kodit penal gjykata gjithashtu të gjithë shtetasve të huaj ju gjykoi edhe dënim dëbim i shtetasit të huaj, përgjithmonë, nga territori i R. së Maqedonisë. Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarve u udhëzua në gjykim civil (граѓанска парница) të realizojë kërkesën pronësore - juridike.

8.4. “Rover”

Duke pasur parasysh faktin se kjo lëndë zgjat disa vite, më poshtë është paraqitur pasqyrim kronologjik i veprimeve gjatë procedurës:

Korrik, 2013 Këshilli gjyqësor i shpalli të gjithë të akuzuarit fajtorë dhe ju përcakton dënime me burg, i vijon: Predrag Çubrillo – burgim të përjetshëm, Millan Iliq – burgim të përjetshëm, Millodrag Kovaçeviq – burgim të përjetshëm, Vuk Vukiçeviq – burgim të përjetshëm, Sashko Jovanovski – 8 vite burg, Ivica Ristiç – 8 vite burg, Ljube Boshkovski – 12 vjet burg, Zoran Trajkovski – 10 vite burg, Nikolla Negrievski – 6 vite burg, Goce Mitrovski – 6 vite burg.

Prill, 2014 Gjykata e Apelit Shkup, e anulon aktgjykimin me arsytet se janë bërë një sërë padrejtësi në procedurën e shkallës së parë.

Nëntor 2014 Gjykata e shkallës së parë në procedurë të re përsëri i shpall të akuzuarit për fajtor. Gjykata kësaj here, te të akuzuarit për ndihmë nuk përcaktoi paramendim për vrasje të Kiro Janev, por vetëm të Marjan Tushevski, dhe të akuzuarit fituan dënime pak më të vogla. Respektivisht, Ljube Boshkovski u dënua me 10 vite burg, Zoran Trajkovski u dënua me 8,5 vite burg, Sashko Jovanovski dhe Ivica Ristiç u dënuan me 7 vite burg, ndërsa Goce Mitrevski dhe Nikolla Negrievskit u janë shqiptuar dënime me burg prej 6 vjet.

Tetor 2015: Për herë të tretë filli gjykimi në Gjykatën Themelore Shkup 1.

Prej atëherë për rastin Rover nuk është mbajtur asnjë seancë gjyqësore, edhe se janë caktuar seanca më 26 maj, 06 shtator, dhe 15.11.2017. Shkaku për prolongimin zakonisht ka qenë mungesa e ndonjëres nga palët. Lëndë ende po vazhdon.

8.5. “Bozhinovski”

Në këtë version si i akuzuar paraqitet gazetari Zoran Bozhinovski ër ekzistimin e dyshimit të bazuar për vepra të kryera penale “Bashkim kriminel” dhe “Spiunazhi”. Një nga shkaqet për prolongimin e një nga seancave në lidhje me këtë lëndë është se dëshmitari / i dëmtuari i kësaj lënde nuk ishte i kapshëm për organet e ndjekjes. Pas informatave të cilat gjykata i ka pasur për këtë lëndë, se i njëjti gjendet në Beograd, nevojitet ti drejtoheshin Gjykatës Supreme në Beograd. Me insistim të mbrojtjes gjykata të mundësojë lidhje konferenciale për marrjen e tij në pyetje, propozimi u pranua, dhe hetimi i të dëmtuarit / dëshmitarit u krye me lidhje video - konferencë. Por për shkak të cilësisë së keqe të lidhjes marrja në pyetje u zhvillua në atmosferë të mundimshme për shkak të ndërprerjeve të shpeshta gjatë marrjes në pyetje, si dhe për shkak të pamundësisë të dëgjohet pyetja ose përgjigjja, ashtu edhe për shkak të ndërprerjes së vetë video lidhjes.

Gjatë mbledhjes së radhës, gjykata fillimisht vendosi për paraburgimin e të akuzuarit sepse prokurori publik kërkoi arresti për të akuzuarin të anulohet respektivisht të mos vazhdohet për shkak të ekzistimit të kushteve ligjore, dhe në veçanti nëse kihet parasysh sjellja e të akuzuarit që ka qenë e kënaqshme dhe shembullore gjatë procesit të deritanishëm në pajtim me LPP vazhdoi të përcaktohen masa të tjera për kujdes. Gjykata kërkesën ë këfillë të prokurorisë e pranoi dhe i përcaktoi të akuzuarit masë kujdesi - obligim përkohësisht të paraqitet tek person zyrtar i caktuar ose te organ shtetëror kompetent dhe heqjen e përkohshme të dokumentit për udhëtim ose dokument tjetër për kalimin e kufirit shtetëror, respektivisht ndalim për lëshimin e dokumentit. Seanca e fundit e mbajtur u prolongua për shkak se u kërkua këqyrje në aktgjykimet për lëndën "Spiun". Procedura është në rrjedhë.

8.6. "Dhuna në Kuvend"

Kjo lëndë është në lidhje me të akuzuarin P. Arsov për kryerjen e veprës penale "Dhunë" (sipas nenit 386 të KP) mbi dy deputetë të Kuvendit të RM-së më datë 27.04.2017, gjatë çka njëri prej tyre ka fituar lëndime të rënda trupore, ndërsa tjetri lëndime te lehta trupore.

Gjatë seancës së parë të mbajtur i akuzuari në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e pranoi fajin dhe në tërësi e pranoi akt akuzën. Fjalët përmbyllëse të prokurorit publik i cili nxori fakte vështirësuese dhe lehtësuese kundër të akuzuarit dhe kërkoi nga gjykata në mënyrë përkatëse të dënojë kryerësin e veprës. I autorizuari i të dëmtuarve mbasi iu bashkëngjiti fjalës përmbyllëse të prokurorit publik, kërkoi nga gjykata të njëjtit ti udhëzojë në seancë për kërkesë pronësore - juridike kundër të akuzuarit. Mbrojtësi dhe i akuzuari dhanë fjalët përfundimtare gjatë të cilave kërkuan nga gjykata dënim më të butë, ndërsa i akuzuari kërkoi i falje para gjykatës të dëmtuarës dhe të gjithë publikut për kryerjen e veprës penale.

Më 12.10.2017 në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup, u shpall publikisht dhe u arsyetua aktgjykimi kundër të akuzuarit P. Arsov, i cili ishte i akuzuar për veprën penale "Dhunë". I akuzuari u dënua me dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 vjet, me atë që logaritet koha e kaluar në burgim shtëpiak.

8.7. "Pavle Bogoevski"

Si i akuzuar në këtë lëndë paraqitet Pavle Bogoevski, aktivisti qytetar, pjesëtar i Revolucionit Laraman, ndërsa tani edhe deputet i zgjedhur në Parlament, nën akuzën se ka marrë pjesë në turmën e cila ka kryer vepër penale, në pajtim me nenin 385 të KP. Kjo procedurë filloi gjatë periudhës së muajit maj 2016 dhe e njëjta ende zgjat. I akuzuari ngarkohet për dëmtimin e fasadës së Ministrisë së Kulturës.

Edhe pse, disa herë ky gjykim ishte prolonguar, ndërsa si rezultat i përcaktimit, ri rregullimit dhe saktësimi të shumës që kërkohet për dëmin, edhe pse kishte filluar seanca kryesore, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për procedurë të shkurtuar (gjatë së cilës nuk ka seanca përgatitore) dhe gjatë kësaj dëshmoi një nga përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës, një nga seancat u prolongua përsëri me obligim i dëmtuari të paraqesë prova plotësuese të cilave u referohet.

Në fakt, edhe pse Ligji për procedurë penale parasheh se me vetë paraqitjen e akt akuzës, respektivisht propozimit, përfaqësuesi i aktakuzës paraqet listë të të provave të cilat më vonë, në seancën kryesore nxirren, gjykata përsëri i mundëson prokurorisë respektivisht të dëmtuarit, në mënyrë plotësuese të propozojnë prova më të sakta të cilat edhe para fillimit të procedurës i ka pasur. Atë që duam ta theksojmë si lëshim për këtë seancë konkrete është mënyra në të cilën është dhënë deklaratë nga i dëmtuari.

Respektivisht, personi i cili dha deklaratë është përfaqësues i ministrisë së dëmtuar dhe i njëjti kishte rol të sqarojë rreth kërkesës pronësore – juridike, respektivisht të shkaktuar dhe eventualisht dëmit të përcaktuar.

Por, përfaqësuesi, filloi të komentojë dhe analizojë ngjarjen kur kinse është kryer vepra me detaje rreth gjendjes faktike ndërsa nuk foli për natyrën teknike - kërkesa për dëmtim e shndërruar në përcaktimin e dëmit material. I njëjti praktikisht jepte deklaratë në vetinë e dëshmitarit për faktet dhe rrethinat për të cilat as nuk ishte i thirrur, as nuk ishte pyetur, kështu në lidhje me pyetjen për mënyrën se si është përcaktuar dëmi, përfaqësuesi i Ministrisë së dëmtuar filloi të ri tregojë ngjarjet të cilat kanë ndodhur në ditën e shkaktimit të dëmtimeve. Edhe pse gjykata nuk i merr parasysh deklaratat në lidhje me pjesën e ndodhive para ministrisë për shkak se përfaqësuesi i të dëmtuarit nuk u pyes as u thërrit në këtë veti, kjo shkaktoi paqartësi në lidhje me vetinë në të cilën personi është thirrur në seancë. Këto paqartësi gjatë dhënies së deklaratës së personit i cili e përfaqësonte të dëmtuarin e imponoi në një mënyrë edhe nevojën që gjykata të ndërmarrë udhëheqjen e procedurës në drejtim të kryerjes së rolit të prokurorit publik gjatë seancës - të bëjë marrjen në pyetje. Pikërisht kjo është detektuar si parregullsi gjatë procedimit në rastin konkret nga Koalicioni – fakti që marrja në pyetje e përfaqësuesit të të dëmtuarit edhe pse me propozim të prokurorisë publike, drejtpërdrejtë ishte kryer nga gjykata. Respektivisht, ligji për procedurë penale në nenin 383 paragrafi 2 parasheh se marrjen e drejtpërdrejtë në pyetje e kryen pala e cila e ka propozuar dëshmitarin, respektivisht ekspertin ose këshilltarin teknik, dhe së këndejmi edhe marrja në pyetje duhej të zhvillohej për pyetje të prokurorit publik dhe do të shndërrohet në marrje në pyetje të veçantë nga gjykata nën paravanin e "sqarimit të fakteve dhe rrethanave". Kjo mundësi është parashikuar në paragrafin 5 të nenit të njëjtë 383 i cili thotë se: "Pas përfundimit të marrjes në pyetje të palëve, kryetari dhe anëtarët e këshillit mund ti parashirojnë pyetje dëshmitarit, respektivisht ekspertit mjeko ligjor".

Ajo që la përshtypje më të madhe nga kjo seancë në fakt është, përzjerja e prokurorisë publike në dhënien e përgjigjeve për këtë përfaqësues (përfaqësuesin e Ministrisë së Kulturës) në lidhje me pyetje të cilat u shtruan nga mbrojtja, më saktë ka ofruar përgjigje dhe ka dhënë sqarime në emër të përfaqësuesit të të dëmtuarit. Që vetëm sugjeron në angazhimet pa rezervë të prokurorisë për të qëndruar akuza e paraqitur dhe vendimi për dënimin e mundshëm për të akuzuarit. Kjo lëndë ende po vazhdon.

8.8. "E majta"

Lëndë në të cilën, të akuzuarit, anëtarët e partisë politike "E majta" – Zdravo Saveski dhe Vladimir Kunovski, ngarkohen për vepër të kryer penale "Pjesëmarrje në turmë që do të kryejë vepër penale" për faktin që ekziston dyshim se njëri prej kryerësve ka hyrë në zyrën e demoluar të presidentit të RM-së, së bashku me një pjesë të turmës, ka ndezur fotografinë e Presidentit dhe ka hedhur sende në drejtim të zyrës së presidentit. Ndërsa i akuzuar i dytë derisa ndodhej në pjesën e brendshme të zyrës së Presidentit, nëpërmjet dritares së thyer ka hedhur disa karrige të zyrës jashtë objektit.

Për shkak se intervali kohor ndërmjet seancave gjatë procedurës ka zgjatur më tepër se 90 ditë, e njëjta filloi nga fillimi. Palët përsëri u prononcuan në lidhje me provat paraprakisht të paraqitura, me çka edhe një herë çështja në lidhje me ekspertizën e realizuar shkaktoi diskutim dhe debat në seancë. Ende sipas mbrojtjes është kontestuese prova – ekspertiza edhe atë në pjesën për lartësinë e dëmit, për shkak se e njëjta është kryer nga i dëmtuari, dhe jo me urdhër të PP-së. Pas çka, gjykata morri vendim se, për lartësinë e detyrimit për lëndën do të prononcohet gjatë procedurës, ndërkaq nuk përjashtohet edhe mundësia të dëmtuarit të udhëzohen edhe në procedurë civile me qëllim realizimin e kompensimit për dëmin. Me kërkesë të mbrojtjes dhe me pëlqim të PP, gjykata morri vendim për anulimin e masave për sigurimin e prezencës - paraqitje në gjykatë.

Me ndërrimin e gjykatësit të kësaj lëndë, gjatë kësaj procedure, shqyrtimi për lëndën filloi nga e para edhe atë me nxjerrjen e përmbajtjes së propozim akuzës, gjatë çka prokurori publik ngeli në propozimin e njëjtë, bëri plotësim në lidhje me listën e provave dhe e paraqiti në seancën e sotme në gjykatë dhe te palët në procedurë, raport të ri të ekspertizës dhe mendim. Për shkak të faktit se palëve gjatë procedurës ju nevojitej kohë të shqyrtojnë provat e reja dhe të prononcohen për të njëjtat, seanca u prolongua. Lëndë ende po vazhdon.

8.9. “Mariglen”

Lëndë e cila mbahet kundër aktivistit qytetar Mariglen Demiri, për “Pjesëmarrje në turmë” – Neni 385 të KP. Gjatë protestave të cilat u mbajtën para zyrës së Presidentit Ivanov, për shkak të abolimit, një pjesë e demonstruesve e demoluan këtë zyrë dhe u shaktua dëm material në pronë publike.

Është vërejtur se një nga seancat e monitoruara është prolonguar sepse përfaqësuesja e Prokurorisë shtetërore, paraqitjen me shkrim (vlerësim në lidhje me dëmin material nga thyerja e dritares së zyrës së presidentit Gjorgje Ivanov) nga Prokuroria shtetërore e ka dërguar një ditë para gjykimit, dhe materiali është fituar 10 minuta para gjykimit. Të gjitha seancat gjyqësore të mëtutjeshme u prolonguan, deri në muajin qershor, kur seanca u mbajt mirëpo përsëri menjëherë u prolongua për shkak se prokuroria nuk i kishte marrë provat nga gjykatësja, e cila ishte transferuar në seksion tjetër në pajtim me orarin e ri. Gjykimi vazhdoi më datë 10.10.2017, kur u prolongua përsëri kësaj here për shkak të sigurimit të provave origjinale, nga PP. Ndërsa seanca e fundit e monitoruar u prolongua me kërkesë të avokatit të mbrojtjes, me qëllim të kryejë këqyrje në dy procesverbalet e paraqitura nga PP. Procedura është në rjedhë.

8.10. “Lagjja e trimave” – procedurë e veçuar

Në këtë lëndë, i akuzuar është një person i cili akuzohet se ka marrë pjesë në ngjarjet në Goshincë dhe Lagjja e Trimave, për të cilën u mbajt procedurë e veçuar me numër referues KOK - 95/16 për shkak se i akuzuari kohë më të gjatë ishte në arrati.

Gjatë seancës kryesore në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të kryqëzuar u morën në pyetje pjesëtarë të policisë në vetinë e dëshmitarëve të Prokurorisë Publike ndërsa në mënyrë plotësuese, u paraqitën prova të tjera, nga PP dhe nga mbrojtja. Në një nga seancat (27.09.17) gjykata mori vendim me të cilin i pranoi provat e propozuara në plotësim nga PP, ndërsa i refuzoi provat e propozuara nga mbrojtja për shkak se nuk ka indikacione se dëshmitarët e propozuar kanë informata me rëndësi për ngjarjen. Pastaj, gjykata mori edhe vendim të nxirret provë e klasifikuar (CD nga aksioni policor) për çka ishte përjashtuar publiku. Pas nxjerrjes së provave dhe përfundimit të lëndës, u morr vendim për dënim, me të cilin nga Gjykata Themelore Shkupi 1, të akuzuarit iu shqiptua dënim me burg të përjetshëm.

8.11. “Ryshfeti”

Lëndë për të cilën i akuzuar është kryeministri aktual i RM-së, për kryerjen e veprës penale në bazë të nenit 357 – “Marrje e rryshfetit”. Mbrojtja në këtë rast kërkoi provat e fituara e zbatimin e MVH "ndjekje sekrete dhe incizim i personave dhe lëndëve me mjete teknike jashtë nga shtëpia ose hapësira afariste e shënuar si private", të ndahet nga lënda sepse të njëjtat anë kryer në hapësira afariste, për çka u sugjeruan edhe aktgjykime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe për shkak të faktit që të njëjtat janë shpallur publikisht, (për çka tani më ekziston edhe praktikë gjyqësore, provat e këtilla të veçohen nga lënda), duke sugjeruar për të a.q. “bomba” të cilat gjykata i refuzoi si prova. Në lidhje me këto, kundërshtoi prokurori publik duke argumentuar se provat nuk janë siguruar në mënyrë jo ligjore por, se janë publikuar në mënyrë jo ligjore, që paraqet vepër të veçantë penale të cilën prokuroria ende e heton. Mbrojtja tha se një pjesë e seancave paraprahe kanë reaguar meqë nuk kanë pasur qasje në këto incizime, pikërisht për shkak të prokurorisë e cila ka theksuar se provën e posedon vetëm në një ekzemplar, dhe njëkohësisht kërkoi edhe përgjegjësi nga Prokuroria publike për shkak se në mënyrë jo përkatëse e kanë ruajtur provën dhe kanë lejuar i njëjti të shpallet publikisht. Pas këtyre argumenteve të kundërshtuara, gjykata vendosi të prolongojë seancën që të ketë kohë të marrë vendim formal, pas plotfuqishmërisë së të cilës do të mund të vazhdojë diskutimi. Kjo lëndë edhe po vazhdon.

8.12. “Sopot”

Në këtë lëndë, njëmbëdhjetë banorë të fshatit të Kumanovës, Sopot, janë akuzuar se në vitin 2003 kanë vendosur minë e cila ka eksploduar, gjatë çka kanë humbur jetën dy ushtarë të NATO-s nga kontingjenti polonez dhe një civil maqedonas. Kjo lëndë u fillua para konstituimit të PSP-së si prokurori e veçantë, mirëpo, në bazë të një nga bisedave të përgjuara të cilat u shpallën publikisht, PSP e ndërmori përgjegjësinë mbi lëndën dhe vazhdoi të paraqitet si prokurori kompetentë në lidhje me këtë lëndë.

Seanca më datë 18.10.2017 (pas kthimit të lëndës mbrapa te gjykata e shkallës së parë në procedurë ankimore) për rastin "SOPOT" u mbajt, dhe në të njëjtën në lidhje me udhëzimet të cilat i dha gjykata për gjashtë të akuzuarit në këtë lëndë, për të drejtat e

tyre gjatë procedurës, të akuzuarit ngelën në deklaratat e tyre që i dhanë gjatë procedurës praprake.

Përfaqësuesi i kuzes në këtë lëndë propozoi prova të reja, materiale dhe verbale dhe kërkoi nga gjykata marrja në pyetje e dëshmitarëve të bëhet pas nxjerrjes së provave materiale të cilat janë relevante për dëshminë e dëshmitarëve. Në lidhje me provat e reja të propozuara, mbrojtja kërkoi kohë nga gjykata me qëllim të njoftohet me të njëjtat, dhe pastaj të prononcohet në lidhje me ato. Ky proces ende është në rrjedhë.

9. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

9.1. Konkluzione të përgjithshme

Sundimi i të drejtës është i lidhur ngushtë me ekzistimin e pushtetit funksional dhe të pavarur gjyqësor. Mungesa e pavarësisë dhe mëvetësisë në punën e gjyqësorit, prokurorisë publike dhe institucioneve tjera të sektorit të jurisprudencës, rezulton edhe me zvogëlimin e kualitetit të punës së këtyre institucioneve, në radhë të parë të gjyqësorit si segment më i rëndësishëm i sektorit të jurisprudencës. Praktika e pabarabartë gjyqësore e gjykatave në shtet është argument shtesë në dobi të zmadhimit të pasigurisë juridike të qytetarëve, gjë që është treguar në të gjitha analizat e deritanishme të realizuara vendore dhe të huaja. Është zbuluar gjendje e lëshimeve në interpretimin dhe zbatimin e ligjeve nga gjykatat themelore, e veçanërisht nga gjykatat e apelit të njëjësive të njëjta ose të ndryshme, gjatë miratimit të vendimeve për baza juridike të njëjta ose të ngjashme. Megjithatë, është e pashmangshme të theksohet edhe argumentimi i pamjaftueshëm dhe i paqartë i aktgjyqimeve dhe moszbatimi i vendimeve të GJEDNJ-së për argumentim të vendimeve.

Qasja e përzgjedhur gjatë veprimit, e veçanërisht në lëndë që kanë një lloj të "notës" politike në vete, të çfarëdo lloj natyre, nuk është lënë pas dore edhe gjatë kryerjes së profesionit të prokurorit publik, përkatësisht gjatë funksionimit të PP-së. Për këtë qëllim edhe ishte formuar prokuroria publike speciale, që edhe krahas legjitimitetit të vet dhe pozicionimit institucional, ende ndeshet me obstrukcione në punën e vet.

Ndikimi politik është vërejtur edhe në vendimet për zgjedhje dhe avancim të kryetarëve të gjykatave dhe gjykatësve në gjykatat më të larta. Kështu, gjatë vitit të kaluar gjatë ekzistimit të indikacioneve për një varg parregullsish në punën e sistemit AKMIS të gjykatave, si dhe shpërndarjes gjoja tendencioze dhe manuale të lëndëve gjyqësore, ishte e domosdoshme të formohet komision për kontroll të tërë sistemit AKMIS të gjykatave, me qëllim të konstatimit të keqpërdorimeve eventuale. Që rezultoi me dyshime për veprimin e kryetarëve të caktuar të gjykatave themelore.

Është konstatuar edhe punë jo transparente e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në lidhje me përmbajtjen e arsytimeve të vendimeve të tyre. Megjithatë, edhe zbatimi i pamjaftueshëm i sistemit për shpalljen e vendimeve gjyqësore dhe mosekzistimi i mjeteve për kërkimin e tyre dërgon në zvogëlim të transparencës në punë.

Në raportin e fundit të Komisionit Evropian për përparimin e vendit¹⁸, është konstatuar se sistemi i jurisprudencës në vend ka nivel të caktuar të gatishmërisë, por megjithatë, gjendja e degradimit nga viti 2014 e këtej dhe arritjet e procesit reformues të dekadës paraprake janë gërmuar nga përzierja e vazhdueshme politike në punën e jurisprudencës.

Është vlerësuar se pushteti nuk mundi ta tregojë vullnetin e duhur politik për zgjidhjen efektive të problemeve të vërejtura në “prioritetet reformuese urgjente”. Drejtësia e përzgjedhur dhe mungesa e pavarësisë në jurisprudencë u paraqitën dukshëm nëpër pengesat me të cilat përballet PSP-ja si institucion.

Në pikëpamje të luftës kundër korrupsionit, është konstatuar nivel i caktuar i gatishmërisë së vendit, por është i pashmangshëm konstatimi se korrupsioni si problem serioz edhe më tej sundon në shumë sfera të shoqërisë. Edhe pse është përgatitur korniza ligjore dhe institucionale, megjithatë, mangësitë strukturore të Komisionit Shtetëror për Parandalim të korrupsionit dhe përzierja politike në punën e tij e minimizuan ndikimin nga përpjekjet paraprake. Është konstatuar “nivel i caktuar” i gatishmërisë së shtetit në luftën kundër krimit të organizuar, gjen mbështetje në harmonizimin kryesor të kornizës ligjore ekzistuese me standardet evropiane, por edhe fakti për strategjitë e përgatitura. Megjithatë, nuk u anashkalua edhe nevoja për zhvillimin plotësues të kapacitetit ekzistues për zbatimin e ligjeve për hetim të krimit financiar dhe konfiskim të pronës.

Në raportin e Departamentit Shtetëror Amerikan për viti 2016¹⁹, e i cili ka të bëjë me respektimin e të drejtave të njeriut u konstatua se problemi më i madh me të drejtat e njeriut në shtet është shpërndarja e thellë e korrupsionit dhe mosuksesi i qeverisë për të mundësuar respektim të plotë të sundimit të të drejtës, duke përfshirë përpjekjet e vazhdueshme për kufizimin e lirisë mediatike, përzierjen në jurisprudencë dhe pamundësimin e funksionimit të papenguar të punës së PSP-së, si dhe drejtësia e përzgjedhur.

E gjithë kjo gjendje e konstatuar me tronditjet e shumta në të gjitha strukturat e shoqërisë, në mënyrën e vet sugjeroi ndryshimet e domosdoshme politike dhe pozicionimin e konstelacionit politik tejet të ndryshëm. Kështu pas mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare në fund të vitit 2016 dhe konstituimit të Qeverisë së re, të udhëhequr nga të gjitha sugjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet e bashkësisë ndërkombëtare, ajo filloi me përpunimin e strategjisë për jurisprudencën dhe realizimin e Planit 3-6-9²⁰, në përmbajtjet e të cilave janë implementuar drejtimit nga sektori joqeveritar të dhëna nëpërmjet dokumentit të hartuar “Propozim për reforma demokratike urgjente” (Blueprint)²¹.

Në pjesën e reformave gjyqësore që paraprijnë, qeveria e re i pranoi vërejtjet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian dhe të Këshillit të Evropës (Komisioni i Venedikut dhe GREKO), me çka ajo u obligua për periudhë të afërt të caktuar kohore (afat të shkurtë,

¹⁸<https://ec.europa.eu/neighbourhood>

enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf

¹⁹ <https://www.state.gov/documents/organization/265658.pdf>

²⁰ <http://vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/Plan%203-6-9%20MKD.pdf>

²¹ <http://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2017/07/Blueprint-2017-MK.pdf>

të mesëm dhe të gjatë) të ndërtojë sistem gjyqësor profesional, të paanshëm të pavarur dhe efikas.

9.2. Konkluzione dhe rekomandime nga monitorimi i zbatuar

- Qëndrojnë problemet e zbuluara për praktikën e moszbatimit të personave të burgosur dhe të paraburgosur nga institucionet përmirësuese ndëshkuese. Shkaqet për këtë më së shpeshti kanë të bëjnë me: Problemet në koordinimin me sistemin për evidencë të shoqërimit të personave të privuar nga liruara, ose të mungesës së financave ose automjeteve për shoqërimin e këtyre personave, por jo rrallë kjo ndodhte edhe gjatë mbajtjes së njëres nga lëndët deri tani më të eksponuara mediatike-“Lagja e trimave”, gjatë mbajtjes së të cilës ishin zmadhuar rreziqet e sigurisë në territorin e të gjitha gjykatave të rrethit.

Rekomandim: Përparimi i koordinimit ndërmjet organeve dhe përmirësimi i Sistemit AKMIS, me qëllim të mënjanimin të këtyre problemeve të vërejtura. Alokimi real i mjeteve buxhetore për funksionimin normal të gjykatave.

- Mungesa e PB-së në debatin e caktuar për shkak të përputhjes së më tepër lëndëve dërgon në ekipimin e pamjaftueshëm të prokurorisë publike, jo vetëm mangësi në pikëpamje të resurseve njerëzore (PP), por edhe në përgjithësi të personave tjerë që janë pjesë e saj.

Rekomandim: Përparimi i koordinimit në sistemin e funksionimit të Prokurorisë Publike dhe zmadhimi eventual i resurseve njerëzore në të.

- Pranimi i fajit, si një nga institutet e reja dhe të përfaqësuara adekuate në sistemin nacional të drejtësisë dënuese, më shpesh zbatohet për veprat penale më të lehta. Me çka mund të gjenerohet konkluzioni se ky institut njihet nga subjektet në procedurë penale si mjet efikas për përfundimin e shpejtë dhe efektiv të procedurave penale.

Rekomandim: Mbrojtja proaktive e drejtësisë në kushte të mendimit të dhënë gjatë debatit kryesor, përkatësisht zmadhimi i rolit të rolit aktiv të gjykatës gjatë vlerësimit të mendimit të dhënë.

- Zbatimi i masave për sigurimin e pranisë së personit të akuzuar, që mund të jenë alternativë e paraburgimit, ndërsa efikasiteti i të cilave është i pranuar në sistemet tjera më të zhvilluara të drejtësisë dënuese, në sistemin tonë është i rrallë. Përveç në lëndët gjyqësore të profiluara, këto praktika të rralla pothuajse edhe nuk hasen në lëndët tjera penale.

Rekomandim: Vendosja e mekanizmit përkatës për zbatimin e kontrollit të masave më të lehta, që gjykatës do t'i jepte të dhëna të mjaftueshme dhe garanci për zbatimin e tyre efikas. Këto mekanizma mund të vendosen nëpërmjet ndryshimeve ligjore në LPP dhe në Ligjin për shërbimin e sprovës nëpërmjet vendosjes së këtyre masave në kompetencë të shërbimeve të sprovës.

- Është evidentuar jokonsekuencë në rendin ligjor të paraqitjes së dëshmive me arsyetimin se bëhet fjalë për ekonomizim të procedurës.

Rekomandim: Të ndiqen dispozitat nga LPP-ja në lidhje me kronologjinë e paraqitjes së dëshmive.

- Mënyra e vërejtjes dhe evidentimit të debateve edhe më tej zhvillohet në mënyrë që ato evidentohen me diktim të drejtpërdrejtë në procesverbal.

Rekomandim: Sigurimi i parakushteve materiale teknike për evidentimin e rrjedhës së debatit kryesor, përkatësisht të mundësohet shfrytëzimi i teknikave bashkëkohore të regjistrimit të përcaktuara me LPP, të cilat në këtë moment janë të kapshme vetëm në një sallë gjykimi të Gjykatës Themelore Shkupi I, Shkup;

- Autorizimi i gjykatës për tu parashtruar pyetje plotësuese dëshmitarëve/ekspertëve etj. është dukuri e shpeshtë e paarsyeshme në debatet e monitoruara, ndërsa në disa raste ky aktivitet zgjerohet në marrje të veçantë në pyetje. Kjo e drejtë doemos duhet të kufizohet në qartësimin e deklaratave të dhëna.

Rekomandim: Ndryshime ligjore në dispozitat e LPP-së që e parashohin këtë mundësi, ndërsa në drejtim të eliminimit të këtij autorizimit të gjykatës.

- Ende evidentohet praktika e komunikimit ex parte edhe atë më së shpeshti ndërmjet gjykatës dhe prokurorisë publike.

Rekomandim: Zbatimi i drejtë i LPP-së nga gjykata dhe në pikëpamje të parimit të paanshmërisë gjatë veprimit dhe lëshimit të kësaj praktike që e rrënon besimin e qytetarëve në gjyqësor.

- Shkalla e transparencës së institucioneve gjyqësore, ndërsa në rastin konkret e Gjykatës Themelore Shkupi 1, Shkup, në gjysmën e dytë të këtij viti pësoi zvogëlim. Anë konstatuar lëshime të shërbimet administrative në gjykata, në drejtim të paraqitjeve joadekuate të kohës dhe vendit të mbajtjes së debateve nga lëndët gjyqësore ose edhe mosparaqitja e tyre aspak.
- Kapacitet i zvogëluar i të dhënave në dispozicion në ueb faqet e gjykatave, e veçanërisht në pikëpamje të llojit të veprës penale, gjë që në sistemin elektronik paraprak ishte e pranishme në ueb faqet e gjykatave, ndërsa është e paarrtshme me implementimin e formatit të vetëm www.sud.mk.

Rekomandim: Përmirësimi i shkallës së publikut dhe transparencës së gjykatave nëpërmjet paraqitjes publike të kohës dhe vendit të debateve publike, si në kuadër të ueb faqes së gjykatave, ashtu edhe në vet ndërtesat e gjykatave.

- Praktikë e evidentuar e shkeljes së të drejtave procesore të mbrojtjes nëpërmjet kufizimit të qasjes të dëshmitë ose vështirësimi i kontrollit të tyre, si dhe koha e matur e papërshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes.

Rekomandim: Ndryshimet e dispozitave ligjore të LPP-së në drejtim të rregullimit plotësues në pikëpamje të eliminimit të praktikës së qasjes së kufizuar të mbrojtësve, të dëshmitë e prokurorisë dhe mundësimi i kohës minimale të nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes.

- Është evidentuar trajtim i ndryshëm i prokurorëve publikë të PP të rregullt, në raport me ato nga PSP gjatë implementimit të dispozitave nga LPP në procedura konkrete.


Rekomandim: Pavarësia e gjykatësve gjatë veprimit, si element kryesor në marrjen e funksionit gjyqësor është e domosdoshëm, e të sigurohet dhe praktikohet. Zbatimi konsekuent dhe i barabartë i dispozitave të parapara në LPP, paraqet maksimum për cilindo praktikues të të drejtës, ndërsa veçanërisht për shpërndarësit e të drejtës, e së këtejmi është i palejueshëm ekzistimi i anshmërisë ndaj palëve në procedurën.

10. LITERATURË E PËRDORUR:

- Ligji për parandalimin e korrupsionit – tekst i pastruar (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 28/02,46/04,126/06, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese 10.01.2007, 10/08, 161/08)
- "Shteti juridik dhe krimi i organizuar", prof. Vllado Kamboski , Fakulteti Juridik Shkup, 1996
- Konventa e OKB kundër krimit të organizuar transnacional, Palermo 2000
- Ligji për punë të brendshme i RM-së (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.42/2014)
- raporti për vlerësimin e korrupsionit, Emina Nuredinoska, Marija Sazdeski, Borjan Gjuzellov
- Ligji për polici financiare (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.55/02).
http://www.finpol.gov.mk/za_upravata.html
- Drejtoria e policisë financiare. Ministria e Financave të R. së Maqedonisë. E qasshme në: http://www.finpol.gov.mk/za_upravata.html
- Analizë e politikave të dënimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit , Tajd Brasher Lidija
- "Analiza e të dhënave nga proceset gjyqësore të mbikëqyrura gjatë vitit 2016", av. Natali Petrovska, doc. dr. Boban Misoski
- "Efikasiteti gjyqësor në përballjen me krimin e organizuar dhe korrupsionin në "shtet të kapur" ", Shkup 2015, Aleksandra Bogdanovska
- "Efikasiteti gjyqësor në përballjen me krimin e organizuar dhe korrupsionin në "shtet të kapur" ", Shkup 2016, Aleksandra Bogdanovska
- Hulumtime empirike të viteve 70 të shekullit të kaluar në SHBA dhe Angli – shih më tepër në: Albert Alschuler, The Defense Attorney 's Role in Plea Bargaining, 84 Yale

Law Journal 1179 (1974); Baldwin J. & McConville M., Negotiated justice: pressures on defendants to plead guilty, London: Martin Robertson, 1977. Ose për hulumtme më të fundit shih: McConville, Mike, Plea Bargaining: Ethics and Politics, pp. 562-587, Journal of Law and Society, Vol 25, No. 4, 1998; Yue, Ma, Prosecutorial Discretion and Plea Bargaining in the USA, Germany, France and Italy: A Comparative Perspective, International Criminal Justice Review, 2002, 12, 22

- Strategjia për reforma në të drejtën ndëshkuese, Ministria e Drejtësisë, Shkup, 2007, Prof. dr. Davor Krapac, Akademik prof. dr. Vlado Kambovski, Prof. dr. Gordana Kallajxhiev, Prof. dr. Gordana Buzharovska e qasshme në:
http://arhiva.vlada.mk/registar/files/strategjia_kazneno.pdf
- Commission staff working document, The former Yugoslav Republic of Macedonia 2016 Report, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf
- Macedonia 2016 Human Rights Report, <https://www.state.gov/documents/organization/265658.pdf>
- Plani 3-6-9 ,Qeveria e Republikës së Maqedonisë,
<http://vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/Plan%203-6-9%20MKD.pdf>
- Propozim për reforma urgjente demokratike,
<http://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2017/07/Blueprint-2017-MK.pdf>



www.all4fairtrials.org.mk
www.otvorenosudstvo.org.mk